



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45 regjistër (JR)  
Datë 15.10.2020

Nr. 47 i vendimit  
Datë 14.12.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.12.2022, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Selim Kryeziu.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6.  
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b”.  
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.  
Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 46.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2018, duke konstatuar se:
  - a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
  - b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - c) ka kryer fshehje të pasurisë;
  - d) ka kryer deklaram të rremë;
  - e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>1</sup> nr. {\*\*\*} prot., datë 19.02.2020, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, tek i cili ka konkluduar mbi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu.

<sup>1</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2020.

5. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që për subjektin e rivlerësimit Selim Kryeziu, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 278, datë 22.07.2020, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kritereve të vlerësuara.

**7.1.** Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij, sipas pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.* (ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.* (iii) *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.* (iv) *Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.* (v) *Sikurse është arsyetuar më sipër, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia, pasi subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si kryetar gjykate dhe ka arritur të përfitojë strehim, rrethanë të cilën e ka shfrytëzuar menjëherë duke përfituar të ardhura monetare dhe jo për qëllimin për të cilin i ishte dhënë.*

**7.2.** Për kriterin e kontrollit të figurës: *Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore, pavarësisht nivelit të ulët të provueshmërisë gjatë hetimeve dhe megjithëse nuk arriti në një vlerësim negativ për këtë kriter, në vlerësimin tërësor gjen të zbatueshme pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të të cilit kjo rrethanë mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut të drejtësia.*

**7.3.** Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Komisioni vlerëson se në bazë të të gjitha fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë dhe konsiderohet “i aftë”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu, ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

### III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 12.10.2020 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit, ankimi i protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., kundër vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63<sup>2</sup>, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji, duke kërkuar:

8.1. Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

8.2. Riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor dhe realizimin e aktekspertimit kontabël me grup ekspertësh, marrjen e provave dhe pyetjen e dëshmitarëve.

8.3. Ndryshimin e vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

8.4. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Selim Kryeziu, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

8.5. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

#### *Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale*

8.5.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se momente përcaktuese të drejtësisë së vendimit të marrë nga Komisioni lidhen me cilësinë e posaçme, që duhet të kenë nga pikëpamja e dijeve profesionale të ekonomistit e jo të juristit, të hartuesit të tabelës analitike të analizës financiare të pasqyruar në vendim, metodologjia e ndjekur për ndërtimin e saj, si dhe saktësia e shifrave të përdorura për nxjerrjen e rezultatit.

8.5.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se në procesin e tij të rivlerësimit evidentohet nga vendimi i Komisionit mungesa e plotë e arsytimit, analizës së pretenduar dhe e deduksioneve logjike përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i janë studiuar provat e dërguara prej tij në Komision, duke evidentuar segmentin kohor ndërmjet dërgimit të këtyre provave në Komision nga subjekti, me kohën e njoftimit të tij nëpërmjet adresës elektronike më datë 14.07.2020, për njoftimin e zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 16.07.2020, pa u marrë në konsideratë provat e dërguara nga ana e subjektit të rivlerësimit.

8.5.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, edhe pse nuk rezulton të jetë vërtetuar ekzistenca e ndonjë prej rasteve të parashikuara nga ky nen. Që të vendoset kjo masë ekstreme duhet të plotësohen dhe provohen në mënyrë të njëkohshme disa kritere, pasi kushtet e përcaktuara në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 janë kumulative, por edhe nëse këto kushte do ishin të ndara nuk përlijet një masë e tillë ekstreme si ajo e shkarkimit nga detyra.

8.5.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit dhe seancës dëgjimore në Komision nuk janë respektuar parimet bazë, sipas ligjit nr. 84/2016, neni 47, i cili të referon në nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si parimi i ligjshmërisë, parimi i drejtësisë dhe paanësisë, parimi i barazisë para ligjit, parimi i mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive

---

<sup>2</sup> “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

kushtetuese të individit, parimi i proporcionalitetit, si dhe parimi për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor.

**8.5.5.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor. Në këtë mënyrë edhe marrja, administrimi, hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë gjyquese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

#### *Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë*

**8.5.6.** Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 45,51 m<sup>2</sup>, ndodhur në Librazhd, blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe shitur nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”) me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2000, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat nga shitja e kësaj banese, për të cilën kishte nevoja urgjente, nuk i ka përdorur për asgjë tjetër përveçse për qëllime banimi e strehimi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar vlerësimi i Komisionit se sjellja jashtëgjyqësore e subjektit dhe ndikimi i saj në cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë ka një rëndësi të veçantë dhe është objekt i rregullimit të normave të etikës gjyqësore në Shqipëri. Për këtë arsye, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit të sanksionuar në këtë nen, qëllimin e ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës.

**8.5.7.** Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 40,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në Librazhd, blerë me çmimin 1.200.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi i vlerës së shitjes së tij në shumën 2.500.000 lekë ka qenë një pasaktësi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni është i njëanshëm në konstatimin se subjekti nuk ka bërë deklarim të saktë, lidhur me periudhën në të cilën ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij, në kushtet kur një konstatim i tillë nuk mbështetet në provat e administruara dhe të marra gjatë hetimit administrativ.

**8.5.8.** Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, me vlerë 60.000 euro, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se diferenca, ndërmjet çmimit prej 61.480 eurosh të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së apartamentit, me çmimin 60.000 euro të përcaktuar në kontratën e shitjes së tij, ka ardhur si pasojë e përcaktimit të çmimit përfundimtar të blerjes. Në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësve<sup>3</sup> për të dhënë hua shumën prej 20.000 eurosh, me të cilat subjekti i rivlerësimit ka shlyer këstin prej 23.000 eurosh për blerjen e apartamentit, subjekti pretendon se kanë qenë në kushtet e mundësisë financiare për të dhënë huan përkatëse.

**8.5.9.** Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë me çmimin 200.000 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, konstatimi i Komisionit se nuk janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit është i gabuar, duke qenë se sipas subjektit mbartim detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat individët rezidentë të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit. Duke qenë se subjekti nuk gjendjet në kushtet e subjekteve që përfitojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë/vit, atëherë sipas tij vlera e fituar nga shitja e automjetit në shumën 100.000 lekë duhet të konsiderohet si e ligjshme.

**8.5.10.** Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen”, me targë {\*\*\*}, blerë me çmimin 8.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se me provat që ka paraqitur në Komision ka arritur të

---

<sup>3</sup> Sh. e A. K. hua 10.000 euro; Xh. K. hua 5.000 euro; E.S. (H.) hua 3.000 euro; N. T. hua 2.000 euro.

provojë dyshimet që lidhen me çmimin e blerjes së këtij automjeti. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka kryer mjaftueshëm hetim dhe provat e dorëzuara prej tij, nuk i ka bërë pjesë të arsyetimit dhe të vendimit objekt shqyrtimi, si dhe nuk ka analizuar kontratën e lidhur mes palëve, gjë që subjekti pretendon të merret në shqyrtim nga Kolegji duke riçelur shqyrtimin gjyqësor.

**8.5.11. Lidhur me të ardhurat si ekspert në Brindisi, Itali,** subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar nga nxitimi shumën 1.197 euro në vend të deklaronte 1.106,7 euro, të cilat i ka përfituar realisht nga puna e tij si ekspert në Brindisi. Sipas subjektit të rivlerësimit rezulton se nga tatimi mbi të ardhurat janë të përjashtuar të gjithë individët të cilët nuk realizojnë të ardhura mbi vlerën 2.000.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, për këtë arsye, vlera e përfituar në Brindisi duhet të përfshihet në analizën financiare duke e konsideruar si të ardhur të ligjshme.

**8.5.12. Lidhur me analizën financiare,** subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se ka kryer disa pasaktësi në plotësimin e deklaratave periodike, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, ku për vitet 2004-2010 ka harruar të bëjë deklaratimet vjetore për kursimet e tij dhe të bashkëshortes. Sipas subjektit këto kursime kanë shërbyer për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit me sip. 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë dhe për të shlyer huat e marra. Subjekti i rivlerësimit pretendon se referuar të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes ka pasur mundësi për të krijuar këto kursime. Subjekti, në përfundim të këtij shkaku ankimi, kërkon të rishikohet analiza financiare për vitet 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2014.

*Shkaku i ankimit lidhur me kontrollin e figurës*

**8.5.13.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimmarrja e Komisionit nuk është e bazuar, pasi në seancën dëgjimore u deklarua nga trupi gjyqësor i Komisionit se për subjektin e rivlerësimit ka informacion për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, të cilat cenojnë figurën e tij dhe në përfundim në vendimin objekt ankimi konkludojnë se nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk u arrit të vërtetohet përfshirja e tij në veprimtari korruptive. Megjithatë në vlerësimin tërësor, Komisioni gjen të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, rrethanë e cila mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut të drejtësia.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj**

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Selim Kryeziu, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*ii. Legjitimimi i ankuesit*

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65<sup>4</sup>, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Selim Kryeziu, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.1. Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim për kryerjen e një aktekspertimi kontabël, thirrjen e dëshmitarëve, marrjen e provave të reja, si dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

11.2. Kolegji vëren se në ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, të protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 12.10.2020, janë bashkëngjitur si prova që shoqërojnë ankimin: (i) procesverbali i seancës dëgjimore në Komision; si dhe (ii) kërkesa, datë 02.10.2020, drejtuar Komisionit nga subjekti i rivlerësimit bashkë me përgjigjen e Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2020. Në këtë shkresë, subjekti i ka kërkuar Komisionit që t'i vihet në dispozicion procesverbali i seancës dëgjimore të datës 16.07.2020, si dhe opinioni i dhënë me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar Theo Jacobs, në përfundim të procesit për subjektin e rivlerësimit. Këto prova shkresore u vlerësuan nga trupi gjykues të panevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe se fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen e Kolegjit, për më tepër këto akte gjenden të administruara në dosjen e Komisionit e, si të tilla, nuk konsiderohen si prova të reja në ankim, duke mos u ndodhur në kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për pasojë, trupi gjykues, bazuar në nenin 49, pika 6, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, vendosi refuzimin e marrjes së tyre si prova të reja në gjykimin në Kolegji.

Lidhur me kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve, rezulton se Komisioni, bazuar në pikën 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se thirrja e dëshmitarëve është e panevojshme dhe vendosi refuzimin e kërkesës për thirrjen e tyre. Kolegji, bazuar në gerrat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se kjo vendimmarrje është e drejtë dhe se thirrja e dëshmitarëve nuk do të tejkalojë thëniet e tyre në deklaratat noteriale dhe personale që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me provat në Komision pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e një ekspertimi me grup ekspertësh kontabël, trupi gjykues vlerësoi se si Komisioni, ashtu dhe Kolegji, bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, në strukturën e tyre organizative si pjesë të Njësisë së Shërbimit Ligjor kanë edhe këshilltarë ekonomikë, të cilët këshillojnë dhe ndihmojnë trupin gjykues për çështjet financiare dhe ekonomike dhe, si rrjedhojë, nuk është e nevojshme në çështjen konkrete kryerja e një aktekspertimi kontabël nga grup ekspertësh.

<sup>4</sup> “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

11.3. Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit për korrigjimin e tyre. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegj, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i rivlerësimit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

11.4. Kolegji, në konkluzion të arsytimit të mësipërm, vlerësoi si të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndaj vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## ***B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit***

### *Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit*

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se momente përcaktuese të drejtësisë së vendimit të marrë nga Komisioni lidhen me cilësinë e posaçme, që duhet të kenë nga pikëpamja e dijeve profesionale, të ekonomistit e jo të juristit, të hartuesit të tabelës analitike të analizës financiare të pasqyruar në vendim, metodologjia e ndjekur për ndërtimin e saj, si dhe saktësia e shifrave të përdorura për nxjerrjen e rezultatit.

12.1. Kolegji vëren se institucionet e rivlerësimit janë organe kushtetuese me kompetenca të përcaktuara në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Aneksin e saj. Në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës përcaktohet se rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, duke parashikuar kështu kompetencën bazë ekskluzive të Komisionit që është kryerja e procesit të rivlerësimit. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Komisioni mbështetet edhe nga Njësia e Shërbimit Ligjor, (në vijim “NjShL”), e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë<sup>5</sup>. Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi strikt financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Sa më sipër, del qartë se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 e kanë pajisur Komisionin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve, bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. *Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.*

---

<sup>5</sup> Neni 22 i ligjit nr. 84/2016.



13. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se në procesin e tij të rivlerësimit evidentohet nga vendimi i Komisionit mungesa e plotë e arsytimit, analizës së pretenduar dhe e deduksioneve logjike përkatëse. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk i janë studiuar provat e dërguara prej tij në Komision, duke evidentuar segmentin kohor ndërmjet dërgimit të këtyre provave më datë 10.07.2020, me kohën e njoftimit të tij, nëpërmjet adresës elektronike më datë 14.07.2020 nga Komisioni, për të realizuar njoftimin e seancës dëgjimore më datë 16.07.2020, pa marrë në konsideratë provat e dërguara nga ana e subjektit të rivlerësimit.

13.1. Kolegji vëren se në datën 10.07.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>6</sup>, paraqiti në Komision shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, për të cilat i ka kaluar barra e provës. Këto shpjegime së bashku me provat e reja në mbështetje të barrës së provës i dorëzoi fizikisht, nëpërmjet të cilave kishte kërkuar thirrjen si dëshmitarë të shtetasve: S. K., Gj. Xh., D. D., R. K., I. S., Sh. dhe A. K., N. T., B. Sh., M. I. Më tej, sërish përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit paraqiti prova shtesë. Në datën 14.07.2020, trupi gjykues njoftoi subjektin me anë të postës elektronike, se pasi administroi dhe shqyrtoi kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve, si dhe pasi mori në shqyrtim këto kërkesa, çmoi se thirrja e tyre është e panevojshme, bazuar në pikën 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, vendosi refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, bazuar në gerrat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, por administroi të gjitha provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, prova të cilat gjenden të materializuara në funksion të arsytimit të vendimit objekt shqyrtimi. *Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.*

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, edhe pse nuk rezulton të jetë vërtetuar ekzistenca e ndonjë prej rasteve të parashikuara nga ky nen. Që të vendoset kjo masë ekstreme duhet të plotësohen dhe provohen në mënyrë të njëkohshme disa kritere, pasi kushtet e përcaktuara në nenin 61, pika 3 janë kumulative, por edhe nëse këto kushte do të ishin të ndara nuk përlligjet një masë e tillë ekstreme si ajo e shkarkimit nga detyra. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është dispozitë referuese e nenit 33 e po të njëjtit ligj, në të cilin përdoret termi *deklarim i pamjaftueshëm*, duke nënkuptuar sjelljen më të rëndë të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë, nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit.

14.1. Trupi gjykues vëren se Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar<sup>7</sup> në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti këtë pretendim të pabazuar në ligj dhe, si i tillë, ai nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër. Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, i cili ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar ky në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj, vlerësohet se pretendimet, në të cilat subjekti i rivlerësimit mbështet këtë shkak ankimi, janë të pabazuara në ligj, për sa kohë parashikimet e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e

<sup>6</sup> E-mail datë 10.07.2020, “Shpjegime dhe parashtrime”.

<sup>7</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019, etj.

rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i të cilave, në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u nënshtrohet parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. *Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.*

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit hetimor administrativ dhe seancës dëgjimore në Komision nuk janë respektuar parimet bazë, sipas ligjit nr. 84/2016, neni 47, i cili të referon në nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si parimi i ligjshmërisë, parimi i drejtësisë dhe paanësisë, parimi i barazisë para ligjit, parimi i mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit, parimi i proporcionalitetit, si dhe parimi për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor. Sa i përket parimeve procedurale, subjekti pretendon se nuk i është respektuar parimi i kontradiktoritetit, i gjykimit të provave dhe fakteve në mënyrë të paanshme, si dhe parimi i dhënies së një vendimi të bazuar në prova dhe në ligj.

15.1. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në këtë kërkim ka pretenduar shkeljen e këtyre parimeve në mënyrë të përgjithshme, pa parashtruar shkeljen e tyre të lidhur me fakte dhe rrethana konkrete gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, duke pamundësuar kështu kontrollin e Kolegjit ndaj këtyre shkeljeve të pretenduara të subjektit të rivlerësimit dhe, si i tillë, ky pretendim nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut ankimi për t'iu nënshtuar shqyrtimit në Kolegj.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor. Në këtë mënyrë edhe marrja, administrimi, hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në veprimtarinë e tij e njëjta trupë gjykuese edhe heton faktet edhe jep vendim, në lidhje me gjetjet e bëra nga ajo vetë, si organ akuzator dhe gjykatë njëkohësisht.

16.1. Trupi gjykues vëren se në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për pretendime të njëjta të kërkuases me ato të cilat ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në ankim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”) ka vlerësuar se nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të Komisionit për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm nuk mund të konsiderohen se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të subjektit kërkuar në seancë publike. Më e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjithë elementëve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (shih, për shembull, *Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989, paragrafi 50). Si rrjedhojë, e, sa më sipër, kjo Gjykatë ka konkluduar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”) në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme. *Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.*

#### ***Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

17. *Apartament me sipërfaqe 45,51 m<sup>2</sup>*, ndodhur në Librazhd, blerë nga subjekti i rivlerësimit me çmimin 437.836 lekë dhe shitur nga Enti Kombëtar i Banesave, me kontratën nr. {\*\*\*} rep.,

nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2000, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se privatizimi i tij është bërë në respektim të plotë të ligjit dhe me një procedurë transparente. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se konstatimi nga ana e Komisionit se ky apartament nuk është përdorur për qëllimin për të cilin ishte dhënë është i gabuar sepse apartamenti ishte i zënë me forcë dhe subjekti ua ka shitur po këtyre shtetasve që banonin në këtë apartament pas kërkesës së këtyre të fundit. Subjekti parashtron se të ardhurat nga shitja e kësaj banese, për të cilën kishte nevoja urgjente, nuk i ka përdorur për asgjë tjetër, përveçse për qëllime banimi e strehimi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar vlerësimi i Komisionit se sjellja jashtëgjyqësore e subjektit dhe ndikimi i saj në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë ka një rëndësi të veçantë dhe është objekt i rregullimit të normave të etikës gjyqësore në Shqipëri. Kodi i Etikës Gjyqësore është miratuar më datë 08.12.2006 nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, në një kohë që apartamenti është blerë në vitin 2000, kështu Komisioni i ka dhënë fuqi prapavepruese Kodit të Etikës së Gjyqtarit. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 62,15 m<sup>2</sup> privatizuar nga babai i subjektit të rivlerësimit, në vitin 1993, subjekti pretendon se mosdeklarimi i kësaj pasurie në Deklaratën e Interesave Private Periodike (në vijim “DIPP”) të vitit 2003 ka ardhur si harresë njerëzore. Për këtë arsye, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit të sanksionuar në këtë nen, qëllimin e ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës.

**17.1.** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: [...] Komisioni çmon se subjektit të rivlerësimit nga institucionet shtetërore i është mundësuar të përfitojë dy herë nga ligji i privatizimit të banesave. Ministria e Drejtësisë, si rezultat i gjendjes së vështirë të banimit, ka kërkuar fillimin e procedurave të përshpejtuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, Selim Kryeziu, por apartamentin e përfituar me privatizim subjekti nuk e ka përdorur për qëllimin për të cilin i ishte dhënë. Pretendimet e tij se i ndikuar nga ndjenja e humanizmit është nxitur ta shesë këtë apartament nuk duken bindëse, konstatohet se apartamenti është shitur 3 herë më shtrenjtë dhe ka fituar një shumë prej 962.565 lekësh. Gjithashtu, apartamenti i ri është blerë në datën 26.12.2000, pra, tre muaj më pas, fakt tjetër ky që bie në kundërshtim me pretendimet e subjektit se gjendej në kushte tepër të vështira banimi dhe ishte në nevoja urgjente strehimi. Komisioni, në rastin konkret, kur subjekti i rivlerësimit e ka përdorur apartamentin e përfituar nga EKB-ja, për qëllim fitimi, çmon se sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit dhe ndikimi i tij në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ka një rëndësi të veçantë dhe është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri. Kodi i Etikës Gjyqësore, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, datë 08.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “[...] gjyqtari nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave private dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë”.

**17.2.** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në deklaratën vetting subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka blerë apartament nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2000, në lagjen nr. {\*\*\*}, Librazhd, me çmimin 615.335 lekë. Pjesa takuese është deklaruar 50%. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti deklaroi të ardhurat familjare dhe kursimet në Francë. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka sqaruar se ky apartament është shitur me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.10.2000, blerësve Q. dhe A. A., për çmimin 1.400.000 lekë. Pjesa takuese është deklaruar 50%. Rreth tre muaj më vonë, subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2000, ka blerë një apartament tjetër me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.200.000 lekë. Në dosjen e administruar në Kolegj, të përcjellë nga Komisioni, gjenden të administruara kontratat e sipërcituara të blerjes dhe shitjes së dy apartamenteve nga subjekti i rivlerësimit.

17.3. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstaton se pasuria objekt shqyrtimi është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën me pagesë të menjëhershme, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2000, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Elbasan dhe palë blerëse Selim Kryeziu, me objekt shitje apartamenti tip me sip. 45,51 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të pandarë, i ndodhur në Librazhd. Sipas pikës 1 të kësaj kontrate, vlera e apartamentit është përcaktuar në shumën 615.335 lekë. Në pikën 5 të kontratës së shitjes është cituar se çmimi zbritet me 30% të vlerës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 09.01.1995, “Për uljen e çmimit të banesave të ndërtuara me fonde shtetërore në rastet e pagesës së menjëhershme nga blerësi”, sipas së cilit zbritja në rastin konkret konsiston në shumën prej 177.500 lekësh nga vlera totale e apartamentit. Sipas detajeve të kontratës, blerësi ka paguar shumën 53.666 lekë me dokumentet nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, të së njëjtës datë 22.12.1998 dhe, për shlyerjen e plotë të vlerës së apartamentit, blerësit i mbetet të paguajë shumën 384.170 lekë, të cilën e ka likuiduar me faturën nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2000, e cituar në kontratën e shitjes. Si rezultat i sa më sipër, si dhe sipas kartelës së pasurisë së këtij apartamenti, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit është paguar shuma 437.836 lekë. Pak ditë më vonë, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.10.2000, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë apartament blerësve Q. dhe A. A., për çmimin 1.400.000 lekë, sipas kësaj kontrate. Lidhur me fitimin e realizuar nga diferenca e çmimit të shitjes dhe blerjes, subjekti i rivlerësimit ka paguar<sup>8</sup> tatimin mbi fitimin e realizuar.

17.4. Lidhur me faktet e rezultuara më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet: (i) ka pasaktësi në deklarin e vlerës së apartamentit të përfutuar nga EKB-ja Librazhd, pasi nga hetimi rezulton se ky apartament është blerë në vlerën 437.836 lekë dhe jo në vlerën 615.335 lekë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratat periodike, ndër vite, bashkëpronësinë mbi apartamentin me sip. 62,15 m<sup>2</sup>, të përfutuar nga privatizimi në vitin 1993; (iii) subjekti i rivlerësimit ka përfutuar në kundërshtim me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, (në vijim ligjin nr. 7652/1992), apartamentin e dytë me sip. 45,51 m<sup>2</sup>, si dhe nuk e ka përdorur për qëllimin për të cilin ishte dhënë, por e ka shitur këtë apartament 3 ditë pasi e ka blerë nga EKB-ja dhe ka përfutuar shumën prej 962.565 lekësh.

17.5. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, vërehet se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim janë të njëjta me sa është pretenduar dhe shpjeguar prej tij para Komisionit, në kundërshtim të rezultateve të hetimit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, datë 10.07.2020, lidhur me barrën e provës, për pasaktësinë në deklarin e çmimit të blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se: *[...] ju informoj se në përgatitjen e përgjigjeve i jam përmbajtur në mënyrë strikte akteve, në këtë rast kontratës së shitjes. Çdo mospërputhje vjen për shkak të mos referimit të memoria e veprimeve, sidomos për faktin se ka kaluar një periudhë 20-vjeçare. Në çdo logjikë të kundërt me sa pohoj, argumentoj që vlera e deklaruar nga ana ime si shpenzim është më e madhe e, si e tillë, vetëm do të rëndonte barrën time të provës justifikuese [...].* Lidhur me këtë pasaktësi në deklarin e vlerës së apartamentit të përfutuar nga EKB-ja

---

<sup>8</sup> Vërtetim i ASHK-së me nr. {\*\*\*}, datë 25.02.2020.

Librazhd, Komisioni, bazuar në shpjegimet dhe provat e administruara gjatë hetimit, çmoi se subjekti shpjegoi bindshëm mospërputhjet e konstatuara.

**17.6.** Lidhur me mosdeklarimin në deklaratat periodike të bashkëpronësisë së apartamentit të përfituar nga privatizimi, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se: *[...] ju deklaroj se kam jetuar në këtë apartament gjatë kohës që kam qenë beqar. Në kushtet kur në ishim tre vëllezër në atë banesë (dy të martuar), si dhe dy prindërit, Ministria e Drejtësisë, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 13.08.1998, i është drejtuar Bashkisë Librazhd për të filluar procedurat e përshpejtuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd Selim Kryeziu. [...]. Sa më sipër, ju deklaroj se familja e babait tim R. K. çdo gjë e ka përfituar në mënyrë të ligjshme dhe çdo gjë me vendime të organeve kompetente shtetërore, në zbatim të ligjeve në fuqi. [...] Kjo pasuri vjen si rezultat i një privatizimi të bërë në vitin 1993, prandaj edhe nëse akoma figuroj bashkëpronar de jure për këtë apartament, mosdeklarimi ka ardhur si harresë njerëzore, për shkak se unë jam pajisur me një apartament nga Enti Kombëtar i Banesave dhe nuk ka asnjë arsye tjetër.*

Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përfituar padrejtësisht nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, subjekti ka sqaruar se: *Ju deklaroj se privatizimi i këtij apartamenti nga EKB-ja është bërë në respektim të plotë me ligjet shqiptare me një procedurë ligjore dhe transparente me një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë drejtuar Bashkisë Librazhd, për shkak të kushteve tepër të vështira ku unë banoja, kur ishim disa pjesëtarë të një familje në një apartament me sip. 62,15 m<sup>2</sup>.*

**17.7.** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit rezulton se, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2020, EKB-ja ka dërguar në Komision praktikën e privatizimit të apartamentit. Sipas këtij dokumentacioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.08.1998, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Bashkisë Librazhd për të filluar procedurat e përshpejtuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, Selim Kryeziu, duke parë gjendjen e vështirë të tij për strehim, pasi banonte në një apartament së bashku me prindërit dhe dy vëllezërit e martuar. Bashkia Librazhd, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.12.1998, “Për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd”, ka vendosur t’i japë për strehim subjektit të rivlerësimit apartamentin me sip. 45,51 m<sup>2</sup>, në Librazhd. Gjithashtu, në praktikën e përcjellë gjendet e administruar shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 25.04.2000, nga EKB-ja Librazhd, drejtuar Komisarariatit të Policisë Librazhd, ku kërkohet lirimi i apartamentit nga shtetasi Q. A., i cili e kishte zënë arbitrarisht që nga viti 1997. Nga dokumentacioni i administruar nga EKB-ja Librazhd, konstatohet se ky apartament ka qenë objekt i një konflikti gjyqësor, pasi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.07.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku subjekti i rivlerësimit ishte në cilësinë e personit të tretë, ishte vendosur pranimi i kërkesë padisë, duke shfuqizuar vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.12.1998, të Bashkisë Librazhd, për dhënien e këtij apartamenti subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2000, vendosi ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.07.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova.

**17.8.** Referuar dokumentacionit bashkëngjitur shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2019, të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Librazhd, rezultoi se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 62,15 m<sup>2</sup>, regjistruar në pronësi si familje. Sipas formularit nr. 3, është lidhur kontratë për privatizimin e banesës, datë 17.04.1993, ndërmjet Ndërmarrjes Komonale të Banesave dhe R. K. dhe me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*}, datë 10.05.1993, është shitur në vlerën 3.995 lekë. Ky apartament figuron i regjistruar në

emër të gjashtë personave. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratat periodike ndër vite bashkëpronësinë mbi apartamentin e përfituar nëpërmjet privatizimit në vitin 1993.

**17.9.** Në vijim të sa më sipër, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfituar apartamentin me sip. 41,51 m<sup>2</sup>, në vitin 2000 nga EKB-ja, në një kohë që mbante detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe njëkohësisht ishte bashkëpronar i apartamentit me sip. 61,25 m<sup>2</sup>, të përfituar nga babai i tij nga privatizimi në vitin 1993, apartament të cilin nuk e ka deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka përfituar dy herë nga privatizimi i banesës dhe njëkohësisht nuk e ka deklaruar bashkëpronësinë e apartamentit të përfituar nga babai në vitin 1993. Në nenin 1 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, parashikohet se: *Ky ligj ka si qëllim të realizojë privatizimin e banesave shtetërore, të krijojë tregun e lirë të banesave private dhe të përmirësojë përdorimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e banesave, duke u dhënë të drejtën qiramarrëseve të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre. Pronarët do të kenë të drejtë ta tjetërsojnë, ta lëshojnë me qira dhe ta hipotekojnë banesën e tyre.* Sipas këtij parashikimi ligjor, subjekti i rivlerësimit ka fituar titullin pronar me blerjen e apartamentit nga EKB-ja dhe si pronar i ligjshëm ka të drejtë ta disponojë lirisht pronën e tij. Në nenin 149 të Kodit Civil përcaktohet instituti i pronësisë si e drejtë për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar me ligj. Në këtë kuptim është e nevojshme të dihet edhe rregullimi ligjor, që i përket kufizimeve që ky ligj (7652/1992) ka parashikuar lidhur me pronësinë.

**17.10.** Në nenin 23 të ligjit nr. 7652/1992 parashikohet se: *Me zbatimin e këtij ligji, në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore.* Sipas dokumentacionit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”), Librazhd, dërguar Komisionit, rezulton, sipas formularit nr. 3 të kësaj praktike, se kontrata për privatizimin e banesës, datë 17.04.1993, për apartamentin e ndodhur në Librazhd, lidhet ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe qiramarrësit R. K. (babai i subjektit të rivlerësimit). Në formularin nr. 2 të kësaj praktike, “Treguesit kryesorë për apartamentin”, identifikohet adresa në të cilën ndodhet apartamenti, në lagjen “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}, Librazhd, si dhe numri i frymëve, sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile më datë 01.12.1992, sipas së cilës është shënuar 6 (gjashtë) frymë, ndërsa numri i familjeve në këtë apartament është shënuar 2 (dy). Më datë 10.05.1993 është lidhur kontrata nr. {\*\*\*} e shitjes së apartamentit me dy dhoma dhe një kuzhinë, me pjesëtarë madhorë 6 (gjashtë) persona (të cilësuar në kontratë si burri, bashkëshortja, 3 fëmijë djem dhe nusja e djalit), ndërmjet shitësit Ndërmarrja Komunale Banesa dhe blerësit R. K. (babai i subjektit të rivlerësimit). Siç del nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit është privatizuar apartamenti me sip. 62,15 m<sup>2</sup> për 6 (gjashtë) persona.

**17.11.** Kolegji vëren se në VKM-në nr. 113, datë 20.01.1997, “Për normat e strehimit në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore”, në pikën 1 dhe 2 të tij parashikohet: *1. Normë strehimi në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore, sipas këtij vendimi, do të kuptohet sipërfaqja e banimit në metër katror që i takon një personi. Sipërfaqe banimi brenda një apartamenti tip i referohet sipërfaqes totale të dhomave të gjumit dhe dhomës së ditës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 06.12.1993, “Për normat e projektimit të banesave”. 2. Norma e strehimit për familjet që trajtohen me banesa të ndërtuara me fonde shtetërore është 9-11m<sup>2</sup>/person (metër katror për person).*

Sipas këtij parashikimi në sipërfaqen e banimit në metër katror që i takon një personi është e përlllogaritshme vetëm sipërfaqja e dhomave të gjumit dhe dhomës së ditës, pa përfshirë këtu

sipërfaqet në metër katror të pjesëve të tjera të banueshme të apartamentit, si korridor, ballkon dhe tualet. Sipas këtij vendimi, sipërfaqja e banimit në metër katror për 6 (gjashtë) persona, të cilët kanë rezultuar madhorë në momentin e privatizimit të banesës, sipas pikës 2 të VKM-së cituar më sipër, duhet të jetë 54 m<sup>2</sup> minimumi deri 66 m<sup>2</sup> maksimumi sipërfaqe që i përket vetëm dhomave të gjumit dhe të ditës. Në kushtet kur sipërfaqja totale e apartamentit ishte 62,15 m<sup>2</sup>, sipas normave të strehimit të përcaktuara në pikën 2 të VKM-së nr. 113, datë 20.01.1997, marshi maksimal (11 m<sup>2</sup> x 6 persona = 66 m<sup>2</sup>) i metrave katror që i përket familjes së subjektit rezulton të ketë qenë nën normën e strehimit për person. Në kushtet kur sipërfaqja totale e përcaktuar, sipas planimetrisë së apartamentit e ndodhur në praktikën e ASHK-së Librazhd, është 62.15 m<sup>2</sup>, pa zbritur këtu sipërfaqet të cilat nuk përfshihen në normën e përcaktuar për person në VKM-në nr. 113 më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka banuar në një apartament jashtë normave të përcaktuara për person, që lejojnë jetesën në normalitet.

**17.12.** Komisioni ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë, si rezultat i gjendjes së vështirë të banimit, ka kërkuar fillimin e procedurave të përsheptuara për strehimin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, Selim Kryeziu, por apartamentin e përfituar me privatizim subjekti nuk e ka përdorur për qëllimin për të cilin i ishte dhënë. Pretendimet e tij se i ndikuar nga ndjenja e humanizmit është nxitur ta shesë këtë apartament, për Komisionin nuk janë bindëse. Komisioni ka konstatuar se apartamenti është shitur 3 herë më shtrenjtë dhe subjekti i rivlerësimit ka fituar një shumë prej 962.565 lekësh. Gjithashtu, Komisioni arsyeton se apartamenti i ri është blerë në datën 26.12.2000, tre muaj më pas, pra, fakt tjetër ky që bie në kundërshtim me pretendimet e subjektit se gjendej në kushte tepër të vështira banimi dhe ishte në nevoja urgjente për strehim.

**17.13.** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit për fitimin e realizuar nga kjo shitje e ka paguar tatimin për të ardhurat e realizuara. Këtë e provoi vetë subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, të sjellë nga ASHK-ja. Për të ardhurat që ka krijuar subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në rastin konkret kur subjekti e ka përdorur apartamentin e përfituar nga EKB-ja, për qëllim fitimi, ka vlerësuar se sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit dhe ndikimi i tij në besimin e publikut të sistemi i drejtësisë ka një rëndësi të veçantë dhe është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri. Menjëherë pas dhënies së apartamentit nga EKB-ja Librazhd, siç ka shpjeguar subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, se blerësit Q. dhe A. A. ishin zotërues të paligjshëm të apartamentit, zënë me forcë në vitin 1997, subjekti i rivlerësimit, duke pasur një ndjenjë humanizmi ndaj tyre dhe me ndërmjetësimin e disa të afërmeve të tyre, sapo e ka blerë këtë apartament nga EKB-ja ua ka shitur blerësve shumë poshtë vlerës që realisht kishte ky apartament, i cili ishte në katin përdhe të pallatit, i kërkuar edhe për biznese të ndryshme. Për faktin se subjekti i rivlerësimit ka shitur apartamentin e dhënë nga EKB-ja më shtrenjtë se çmimi i blerjes, Komisioni ka konkluduar se ka cenuar besimin e publikut duke thyer Kodin e Etikës Gjyqësore, sipas rregullit nr. 3 të këtij kodi.

**17.14.** Trupi gjykues konstaton se Kodi i Etikës Gjyqësore është miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006. Subjekti i rivlerësimit ka shitur apartamentin e përfituar nga EKB-ja në vitin 2000, periudhë e cila daton 6 vjet para miratimit të Kodit të Etikës Gjyqësore, ndaj rregullat e këtij kodi nuk mund të kenë fuqi prapavepruese në drejtim të etikës së subjektit të rivlerësimit për rastin konkret. Çdo veprimtari, me qëllim përfitimin e të mirave materiale ose jomateriale, duhet të jetë e tillë që të mos sjellë ndikime në pavarësinë e ushtrimit të funksioneve apo detyrave të gjyqtarëve, në drejtim të përdorimit të detyrës për interesa privatë. Në çështjen konkrete, subjekti i rivlerësimit nuk duket se ka cenuar besimin e publikut, pasi ai

është ekspozuar në një marrëdhënie ku përfitimet materiale të tij kanë buruar nga qëllimi për t'u pajisur me apartament për strehim, si një e drejtë themelore bazike që i ishte mohuar deri në atë moment. Pra, ekspozimi i subjektit të rivlerësimit në një lloj marrëdhënieje të tillë, ku ka shitur apartamentin që iu akordua nga EKB-ja për shkak të konfliktit me poseduesit e paligjshëm dhe ka blerë një tjetër për të njëjtat qëllime strehimi, nuk e ka bërë atë një subjekt që mund të ndikohet në ushtrimin e detyrës në mënyrë të pavarur dhe jo etike, përkundrazi për fitimin e realizuar subjekti i rivlerësimit është sjellë me korrektësi ndaj legjislacionit tatimor, duke kryer detyrimet që i lindën mbi fitimin e realizuar nga diferenca në shitblerje të apartamentit.

**17.15.** Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit çmon se apartamenti me sipërfaqe 62,15 m<sup>2</sup>, i përfituar nga ligji i privatizimit të banesave nga babai i subjektit të rivlerësimit, nuk është deklaruar prej këtij të fundit, si pasuri në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllezërit. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklaramin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra, shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këto rrethana faktike të mosdeklarimit të pasurisë në bashkëpronësi që në vitin 1993, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Meqenëse vlerësohet se kjo pasaktësi nuk ka pasur si qëllim mbulimin e ndonjë situatë të dyshimtë, si dhe nga ana tjetër nuk vihet në dyshim burimi i krijimit të pasurisë, kjo pasaktësi, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkak shkakimi për subjektin e rivlerësimit.

- 18.** *Apartament me sipërfaqe 40,4 m<sup>2</sup>*, ndodhur në Librazhd, me vlerë 1.200.000 lekë, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarami i çmimit të shitjes së tij, në shumën 2.500.000 lekë, ka qenë një pasaktësi. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se gabimisht i ka shtuar vlerës së shitjes së apartamentit prej 1.900.000 lekësh edhe shumën prej 600.000 lekësh nga kursimet e studimeve në Francë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se janë të ardhura të kursyera nga bursa e studimeve në Francë për periudhën maj 1996-dhjetor 1997 dhe se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, pasi nga njëra anë pranon si provë një dokument të lëshuar nga Ambasada Franceze, nga ana tjetër nuk e përfshin në tabelën financiare si të ardhur të ligjshme, duke e bërë këtë vendim nul, pasi është i paarsyetuar dhe në kundërshtim me vetë provat e pranuar dhe të shqyrtuara nga Komisioni. Sipas subjektit, Komisioni ka gabuar në konstatimin se subjekti nuk ka bërë deklaram të saktë, lidhur me periudhën në të cilën ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij, në kushtet kur një konstatim i tillë nuk mbështetet në provat e administruara dhe të marra gjatë hetimit administrativ.

**18.1.** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni vëren se bazuar në nenin 33, pika 5, germa "a" e ligjit nr. 84.2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me periudhën në të cilën ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij. [...] Në konkluzion, referuar mospërputhjeve lidhur me vlerën e apartamentit, Komisioni, për efekt të analizës financiare, vendosi të marrë në konsideratë vlerën 1.900.000 lekë, bazuar kjo dhe në çmimin e kontratës së shitblerjes".*

**18.2.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka blerë, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2000, apartament banimi me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, në Librazhd, nga shitësit K. dhe H. Zh.. Vlera e apartamentit është 1.200.000 lekë dhe pjesa takuese 50%. Sërish në



deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *shitur apartamenti me sip. 40,4 m<sup>2</sup> blerësve O. dhe A. M., me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2005, në vlerën 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 45,51 m<sup>2</sup>, (trajtuar në paragrafin 17 më sipër), ndodhur në Librazhd.*

**18.3.** Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi ndërtuar para vitit 1999, me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, ndodhur Librazhd, në vlerën 1.200.000 lekë, blerë nga K. dhe H. Zh., pas shitjes së apartamentit të marrë nga EKB-ja Elbasan. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *shitur O. M. apartament banimi 1+1, në lagjen nr. {\*\*\*}, Librazhd, në vlerën 2.500.000 lekë.*

Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar çmimin e shitjes së këtij apartamenti në shumën 2.500.000 lekë, ndërkohë referuar kontratës së shitjes çmimi i apartamentit është 1.900.000 lekë. Pra, ka mospërputhje midis deklarimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në dosje.

**18.4.** Kolegji vëren se nga hetimi administrativ, bazuar në dokumentacionin e administruar nga ASHK-ja Librazhd, rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit ka qenë e regjistruar pasuria nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, zona kadastrale nr. {\*\*\*}, Librazhd, e llojit apartament me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, e shitur në datën 10.10.2005. Kjo pasuri është blerë nga subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2000, me palë shitëse K. e H. Zh. dhe palë blerëse Selim Kryeziu, në vlerën 1.200.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më datë 10.10.2005, subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., ia ka shitur këtë apartament blerësve O. dhe A. M., me çmimin 1.900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Duke krahasuar dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit, rezultoi se në deklaratën e para fillimit të detyrës dhe në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çmimin e shitjes së apartamentit në shumën 2.500.000 lekë. Në deklaratën *vetting* është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është shitur me çmimin 1.900.000 lekë, po kështu edhe në kontratën e shitjes rezultoi se apartamenti është shitur me këtë çmim.

**18.5.** Duke u nisur nga këto mospërputhje të rezultuara nga dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga ky transaksion. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 25.02.2020, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Në lidhje me këtë pasaktësi të konstatuar me të drejtë nga ana juaj, për apartamentin në Librazhd me sip. 40,4 m<sup>2</sup>, që ua kam shitur blerësve O. dhe A. M. më datë 10.10.2005, në shumën 1.900.000 lekë dhe gabimisht në deklaratën periodike vjetore të interesave private të vitit 2005 e kam deklaruar të shitur në shumën 2.500.000 lekë, ju deklaroj se ka qenë një gabim i bërë nga ana ime, pasi shumës së shitjes 1.900.000 lekë gabimisht i kam shtuar edhe shumën prej 600.000 lekësh të kursyer nga studimet e mia në Francë.* Në mandatarëtimin me nr. {\*\*\*}, bashkëngjitur shkresës së ASHK-së, me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, provohet se tatimi mbi fitimin e realizuar nga shitja është përlllogaritur mbi çmimin, sipas kontratës së shitjes 1.900.000 lekë, si rrjedhojë tatimi i fitimit i paguar nga subjekti i rivlerësimit është në masën 9.500 lekë.

**18.6.** Trupi gjykues konstaton se bashkëngjitur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sjellë një vërtetim të lëshuar nga Ambasada Franceze në Shqipëri, Zyra e Bashkëpunimit dhe Veprimtarisë Kulturore, së bashku me përkthimin e kortezisë realizuar nga kjo ambasadë. Ky vërtetim mban datën 26.06.2020, sipas së cilit vërtetohet se shuma e bursës EGIDE është marrë çdo muaj nga Selim Kryeziu, nga muaji maj i vitit 1996 deri në muajin dhjetor të vitit

1997, për studimet e tij në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Bordo, Francë. Sipas këtij vërtetimi shuma prej 5.565 frangash franceze, mundësonte në atë kohë mbulimin e shpenzimeve me lehtësi. Në vijim të këtij dokumenti, nga Ambasada Franceze, Zyra e Bashkëpunimit dhe Veprimtarisë Kulturore e ngarkuar me bursat, citohet se duket e besueshme që Selim Kryeziu të ketë kursyer ekuivalentin e 600.000 lekëve, përgjatë 20 muajve të tij në Francë.

**18.7.** Kolegji vëren se dokumenti është lëshuar nga përfaqësia diplomatike e Francës në Shqipëri, ku ka selinë edhe Zyra e Bashkëpunimit dhe Veprimtarisë Kulturore, që sipas vërtetimit të lëshuar nga kjo Ambasadë është e ngarkuar për çështjet e bursave, e cila mund të përlllogarisë me saktësi se sa mund t'i duhet një studentit për shpenzimet bazë gjatë jetës studentore në Francë, por kjo nuk provon mundësinë e kursimit të një studentit në Francë, dhe se të ardhurat nga bursa mund të mjaftojnë edhe për kursime. Bazuar në praktikën<sup>9</sup> e Kolegjit, të ardhurat që një student përfiton nga bursa akordohen si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetike pa përfshirë shpenzimet e luksit. Nisur nga ky qëndrim i Kolegjit, të ardhurat nga bursa, duke qenë minimaliste për përbalimin e një standardi bazik jetese të studentit, nuk mund të mjaftojnë për të krijuar kursime, siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

**18.8.** Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni, për periudhën 1994-2003, nuk ka përfshirë të ardhurat nga bursa në vlerën 600.000 lekë, por gjithsesi nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të përbaluar jetesën dhe blerjen e pasurive gjatë kësaj periudhe. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk e ka ngritur shkakun e ankimit në kuadër të justifikimit të diferencave negative për këtë pasuri, por për faktin se, nëse këto të ardhura do të konsideroheshin, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare do të rezultonte me diferencë më të lartë pozitive deri në vitin 2003, por kjo nuk do të jepte efekt në zgjidhjen e çështjes, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* prej 1.000.000 lekësh, e cila është vlerësuar nga Komisioni se është krijuar me burime të ligjshme. Edhe në rast se do pranohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kursimin prej 600.000 lekësh nga bursa e studimit, ajo nuk mund t'i shtohet vlerës së gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën fillestare për vitin 2003.

**18.9.** Komisioni, me kalimin e barrës së provës, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, pasi ka konstatuar se nuk ka deklaruar ku ka jetuar nga momenti i shitjes së apartamentit (datë 10.10.2005), deri në tetor të vitit 2006, kohë kur ka deklaruar se ka filluar të banojë në apartamentin e blerë, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka deklaruar se gjatë periudhës që ka shitur apartamentin në Librazhd deri në mesin e muajit tetor 2006 ka jetuar në një apartament me prindërit. Subjekti shpjegoi se apartamentin e shitur nuk e ka liruuar menjëherë në datën 10.10.2005, por më pas, duke qenë se i është dashur të heqë shumë pajisje, të cilat nuk ishin përfshirë në çmimin e shitjes dhe i ka stacionuar në lokalitë e babait. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti dorëzoi deklaratën e lëshuar në datën 04.07.2020 nga R. K., babai i subjektit. Komisioni, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84.2016, ka vlerësuar se subjekti nuk ka bërë deklaratim të saktë lidhur me periudhën në të cilën ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij.

**18.10.** Kolegji, lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në pyetësonin nr. 1 të Komisionit, kur subjekti i rivlerësimit është pyetur për adresat e banimit, nuk e ka deklaruar faktin që ka banuar në shtëpinë e prindërve për një segment kohor prej rreth një viti. Kjo pasaktësi e dalë gjatë procesit të rivlerësimit nuk rezulton

---

<sup>9</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 9/2018 (JR), datë 24.10.2018.

të jetë shoqëruar me ndonjë mungesë të burimeve financiare të ligjshme apo me dyshime të tjera, të cilat parashikohen në pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si e tillë, për trupin gjykues të Kolegjit nuk përbën relevancë që të kualifikohet si shkelje për subjektin e rivlerësimit apo të renditet në kategorinë e pasaktësive, të cilat çojnë subjektin në vendosjen e masës disiplinore.

19. *Apartament me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, me vlerë 60.000 euro, për të cilin subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se diferenca ndërmjet çmimit prej 61.480 eurosh të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së apartamentit, me çmimin 60.000 euro të përcaktuar në kontratën e shitjes së këtij apartamenti, ka ardhur si pasojë e përcaktimit të çmimit përfundimtar të blerjes. Subjekti pretendon se përfshirja nga Komisioni në analizën financiare të vlerës prej 1.480 euro nuk është e justifikuar dhe e bazuar në asnjë akt. Sipas subjektit të rivlerësimit ky ndryshim në çmim ka ardhur si rrjedhojë e moskryerjes nga firma e ndërtimit të disa punimeve të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së lidhur më datë 12.05.2005. Sipas subjektit të rivlerësimit deklarimet e gjendjes *cash* në banesë kanë qenë thjesht harresa njerëzore. Subjekti parashtron se këto kursime të padeklaruara gabimisht kanë shërbyer për të kryer pagesat e kësteve të apartamentit. Në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësve<sup>10</sup> për të dhënë hua shumë prej 20.000 eurosh, me të cilat subjekti i rivlerësimit ka shlyer këstin prej 23.000 eurosh për blerjen e apartamentit, subjekti pretendon se kanë qenë në kushte të mundësisë financiare për të dhënë huan përkatëse.*

**19.1.** *Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: Në përfundim të analizës për këto hua, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave në vlerën 20.000 euro dhe kjo përbën mospërbushje të detyrimit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në kuadër të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin jo vetëm të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tyre, por edhe të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve të tyre për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këtë kuptim, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimeve, shpjegimeve dhe provave të dorëzuara gjatë prapësimeve, subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

**19.2.** *Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerë apartament në Tiranë, me sip. 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2007, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me burim nga shitja e apartamentit në Librazhd, kursimet e familjes, hua pa interes dhe pa afat: 10.000 euro kumatës Sh. K., me biznes privat (shlyer në vitet 2009-2010), 5.000 euro vëllait Xh. K. të fituara nga puna si kuzhinier në Greqi (shlyer në vitet 2007-2008), 3.000 euro kumatit E. H. (S.) të fituara nga puna si emigrant në Greqi (shlyer në vitin 2008), 2.000 euro shokut tim N. T. me biznese private në Librazhd (shlyer në vitet 2007-2008). Vlera e apartamentit 60.000 euro, pjesa takuese 50%.*

**19.3.** *Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Prenotuar apartament 2+1, në Tiranë, rruga “{\*\*\*}”, te shoqëria “{\*\*\*}”, me administrator B. Sh., [...] Likuiduar 50% e vlerës ose 32.000 euro. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: Detyrim financiar ndaj shoqërisë “{\*\*\*}”, [...], sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 12.10.2005, për prenotim apartamenti në Tiranë [...] gjendja e detyrimit 29.480 euro.*

---

<sup>10</sup> Sh. e A. K. hua 10.000 euro; Xh. K. hua 5.000 euro; E. S. (H.) hua 3.000 euro; N. T. hua 2.000 euro.

**19.4.** Në Deklaratën e Interesave Private të Para Fillimit të Detyrës, si Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Prenotuar apartament 2+1, në Tiranë, rruga “{\*\*\*}”, te shoqëria “{\*\*\*}”. [...] Pague 55.000 euro shoqërisë “{\*\*\*}”.*

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: *(i) detyrim financiar ndaj kumatës Sh. K. me banim në Përrenjas, për blerjen e apartamentit në Tiranë, pa afat dhe pa interes, shuma e detyrimit 10.000 euro; (ii) detyrim financiar ndaj vëllait Xh. K., për blerjen e apartamentit në Tiranë, pa afat dhe pa interes, shuma e detyrimit 5.000 euro; (iii) detyrim financiar ndaj kumatit E. H. (S.), për blerjen e apartamentit, pa afat dhe pa interes, shuma e detyrimit 3.000 euro; (iv) detyrim financiar ndaj N. T., për blerjen e apartamentit, pa afat dhe pa interes, shuma e detyrimit 2.000 euro.*

**19.5.** Lidhur me vijueshmërinë e shlyerjes së detyrimeve financiare të listuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitet në vazhdim sipas deklaratave periodike, si më poshtë.

*Në DIPP-në e vitit 2007, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin ndaj kumatës Sh. K. ende në vlerën 10.000 euro, ka deklaruar shlyerjen e huas në vlerën 3.000 euro nga 5.000 euro të marrë hua ndaj vëllait Xh. K., detyrimin financiar ndaj kumatit E. H. (S.), në shumën 3.000 euro dhe shlyerje huaje në vlerën 1.000 euro nga 2.000 euro të marrë ndaj N. T..*

*Në DIPP-në e vitit 2008, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj kumatës Sh. K. ende në vlerën 10.000 euro, ka deklaruar shlyerje e huas të mbetur në vlerën 2.000 euro nga 5.000 euro të marrë hua ndaj vëllait Xh. K., shlyerjen e detyrimin financiar ndaj kumatit E. H. (S.) në shumën 3.000 euro dhe shlyerje huaje e mbetur në vlerën 1.000 euro nga 2.000 euro të marrë ndaj N. T..*

*Në DIPP-në e vitit 2009, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar shlyerjen e vlerës 5.000 euro nga 10.000 euro që është detyrimi financiar ndaj kumatës Sh. K..*

*Në DIPP-në e vitit 2010, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e vlerës së mbetur prej 5.000 eurosh nga detyrimi financiar i mbetur ndaj kumatës Sh. K..*

**19.6.** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, me shkresën<sup>11</sup> e përcjellë në Komision nga AShK-ja Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar më datë 22.05.2015 pasurinë apartament banimi me nr. {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, fituar me kontratën e shitjes së datës 31.12.2007, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., sipas së cilës Selim Kryeziu ka blerë këtë apartament me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, me çmimin 60.000 euro, të cilin e ka shlyer plotësisht jashtë zyrës noteriale.

**19.7.** Meqenëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 prenotimin e apartamentit nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë kontratën e sipërmarrjes, datë 12.10.2005, për prenotim apartamenti, të japë shpjegime të hollësishme lidhur me kohën, kështet e likuidimit të pagesave dhe burimet që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues lidhur me pagesat, huat dhe likuidimin e tyre.

**19.8.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në datën 25.02.2020, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.10.2005, ndërmjet palëve kontraktuese shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe porositësit Selim Kryeziu. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se është i vetmi blerës në pallatin e ndërtuar nga kjo shoqëri që e ka blerë

---

<sup>11</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2019.

apartamentin më shtrenjtë nga të gjithë banorët e tjerë dhe se mandatpagesat nuk i disponon për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe se nuk kishte memorizuar nëse i ka disponuar ndonjëherë, duke qenë se ka pasur njohje me administratorët e kësaj shoqërie dhe prej tyre nuk janë vënë ndonjëherë në dyshim pagesat e kryera.

**19.9.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka deklaruar se detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese nuk ka qenë 6.480 euro, por 5.000 euro, për arsye se firma përcaktoi çmimin përfundimtar të shitjes, duke qenë se nuk përfundoi punimet e njërit prej tualeteve të banesës. Subjekti pretendon se këto punime të papërfunduara i ka kryer së bashku me mikun e tij të fëmijërisë dhe vëllain e tij. Në lidhje me mosdeklarimin e shumës së mbetur pa likuiduar, subjekti shprehet se duke deklaruar se ka paguar vlerën 55.000 euro ka nënkuptuar edhe faktin se ka pasur një detyrim në shumën 5.000 euro.

**19.9.1.** Kolegji vëren se lidhur me deklarimin e vlerës së ndryshme për blerjen e apartamentit, 61.400 euro në kontratën e sipërmarrjes dhe 60.000 euro në kontratën e shitjes së apartamentit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, te të cilat ka konstatuar se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar, në përputhje me ligjin në DIPP-në e vitit 2006, detyrimin e lindur ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 5.000 euro. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti shpjegoi se: [...] Për punimet e pakryera nga “{\*\*\*}” ShPK, Komisioni nuk duhet të llogarisë vlerën 1.480 euro, pasi rregullimet për tualetin e apartamentit me përmasa përafërsisht 1x1.3, nuk janë kryer në vitin 2007 dhe kanë kushtuar 20.000 lekë (shpenzimet për vendosjen e derës dhe pajisjeve). Subjekti nuk ka paguar kosto për punimet, pasi ato janë kryer nga vëllai i tij, R. K. dhe shoku i fëmijërisë D. D., duke sqaruar, gjithashtu, se një pjesë e materialeve (si pllakat për veshje) kanë tepruar nga ndërtimi i shtëpisë së vëllait. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme, subjekti depozitoi deklaratën, datë 30.06.2020, në formën e një shkrese të thjeshtë, e nënshkruar nga vëllai R. K. dhe shoku i fëmijërisë D. D.. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky apartament është blerë në vlerën 60.000 euro dhe jo 61.480 euro.*

**19.9.2.** Kolegji konstaton se në kontratën e sipërmarrjes<sup>12</sup> të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Komision bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 është përcaktuar çmimi në shumën 580 euro/m<sup>2</sup>. Në këtë kontratë nuk është përcaktuar vlera totale e apartamentit, por në një shumëzim të sipërfaqes totale (106 m<sup>2</sup>) me çmimin e dakordësuar për m<sup>2</sup> (580 euro) rezulton vlera totale në shumën 61.480 euro. Në nenin 850 të Kodit Civil, me titull “Përmbajtja”, që i përket Kreut VII me titull “Sipërmarrja”, parashikohet: *Sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë) ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.* Sipas këtij parashikimi palët dakordësohen për kryerjen e punimeve sipas porosisë së porositësit, të cilat merren përsipër të përfundohen nga sipërmarrësi kundrejt çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes. Duke qenë një kontratë, e cila lidhet për një send të ardhshëm, i cili nuk është ndërtuar akoma, palëve iu lind e drejta të rishikojnë çmimin, për sa kohë mund të bëhen ndryshime në projekt nga porositësi (neni 860 i Kodit Civil) ose mund të ndryshojë cilësia e punimeve nga sipërmarrësi.

**19.9.3.** Trupi gjykues konstaton se në nenin e titulluar “Cilësia e Punimeve dhe garancia”, në kontratën e sipërmarrjes objekt shqyrtimi, është parashikuar: *Porositësi ka të drejtë të bëjë*

<sup>12</sup> Kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.10.2005.

*ndryshime të projektit të planimetrisë së apartamentit të tij, ndryshime që nuk prekin anën konstruktive, arkitektonike dhe funksionale të ndërtesës. Nëse kostoja e ndryshimeve është mbi atë të llogaritur, porositësi do të paguajë diferencën për punimet shtesë, ndryshimet duhet të aprovohen nga sipërmarrësi. Nga ky nen i kontratës së sipërmarrjes kuptojmë se gjatë punimeve ose në përfundim të tyre mund të ketë ndryshime të cilat mund të reflektohen në çmim, por që mund të zgjidhen me marrëveshjen e palëve nënshkruese. Për sa kohë në kontratën e shitjes është përcaktuar çmimi i shitjes 60.000 euro, krijohet bindja se ky është çmimi përfundimtar i dakordësuar ndërmjet palëve nënshkruese për të kompensuar punimet e papërfunduara, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se çmimi i referuar në kontratën e shitjes (60.000 euro) vlerësohet të jetë vlera reale e shitjes së këtij apartamenti.*

**19.10.** Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për datat e pagesës së kësteve, Komisioni vlerësoi që analiza financiare duhet kryer në datat në vijim: (i) për këstin e parë në vlerën 32.000 euro është konsideruar moment pagese, data 12.10.2005, bazuar në kontratën e sipërmarrjes, paragrafi “pagesa e kësteve” dhe deklarimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2005; (ii) për këstin e dytë në vlerën 23.000 euro është konsideruar moment pagese, data 15.11.2006, bazuar në deklarimin e subjektit në deklaratën përpara fillimit të detyrës si inspektor i KLD-së, ku ka deklaruar se ka paguar 55.000 euro për apartamentin deri në atë moment; (iii) për këstin e tretë në vlerën 5.000 euro është konsideruar moment pagese, data 31.12.2007, bazuar në deklarimin e subjektit në pyetësin nr. 2, ku deklaroi se detyrimi i mbetur prej 5.000 eurosh është shuar në datën 31.12.2007 dhe referuar kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2007, ku citohet se çmimi i shitblerjes prej 60.000 eurosh është shlyer jashtë zyrës noteriale. Të njëjtat data të pagesave të kësteve për blerjen e apartamentit janë marrë në konsideratë edhe nga Kolegji.

**19.11.** Lidhur me pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, në shumën 32.000 euro, i cili sipas kontratës së sipërmarrjes specifikohet se është paguar që me lidhjen e saj, është konsideruar, data 12.10.2005, momenti i pagesës. Komisioni, duke analizuar mënyrën e deklarimit në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në deklaratat e viteve 2011 dhe në vijim, si edhe duke konstatuar që subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006 (si inspektor i KLD-së), konsideroi që likuiditetet *cash* në fund të çdo viti: 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 kanë qenë 0 (zero) lekë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në datën 12.10.2005, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për diferencën negative në shumën 1.898.258 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, ndaj për këtë diferencë negative i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati.

**19.11.1.** Kolegji vëren se në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën 1.000.000 lekë gjendje *cash* në banesë në datën 31.12.2003, si kursime familjare me bashkëshorten dhe nga bursa e studimit në Francë. Në deklaratat periodike të viteve 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësime apo shtesa të kësaj vlere dhe as gjendje *cash*. Në pyetësin nr. 3 të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë fakt dhe në përgjigje të këtij pyetësi subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për shkak të moskuptimit të saktë të mënyrës së plotësimit të deklaratave të pasurisë, rubrika pakësime/shtesa për disa vite nuk është plotësuar saktë prej tij. Subjekti

sqaron se nga përfundimi i studimeve në dhjetor 1997 deri në vitin 2010, të gjitha paratë e kursyera i ka pasur gjendje *cash*, për shkak se ka bërë likuidimin e huave të marra te të tretët, hua të cilat janë shlyer ndër vite siç janë deklaruar në deklaratat përkatëse. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore nuk ka deklaruar si burim të shlyerjes së huave, kursimet e tij. Subjekti, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe në ankim, ka argumentuar se mosdeklarimet e gjendjes *cash* në banesë kanë qenë thjesht harresa njerëzore. Subjekti pretendon se këto kursime të padeklaruara gabimisht kanë shërbyer për të kryer pagesat e kësteve të apartamentit.

**19.11.2.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2005 nuk ka deklaruar burim të krijimit të pasurisë apartament me sip. 98 m<sup>2</sup>, ndërsa në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar burim krijimi të pasurisë *kursimet nga familja*. Nga NjShL në Kolegj u krye analiza financiare duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e fragmentuara deri në datën 12.10.2005, që është momenti i pagesës së këstit prej 32.000 eurosh, pa përfshirë likuiditetet në banka, si dhe gjendjen *cash* prej 1.000.000 lekësh në banesë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003 dhe për të cilin nuk ka deklaruar as pakësim as shtim. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, për të kryer pagesën e këstit të parë prej 32.000 eurosh për blerjen e apartamentit deri në datën 12.10.2005, për diferencën negative në shumën 1.849.738 lekë. Si rrjedhojë e kësaj analize, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e këstit prej 32.000 eurosh për blerjen e apartamentit, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**19.12.** Në lidhje me pagesën e këstit të dytë në vlerën 23.000 euro, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, se nuk disponon mandatpagesa për shkak të kohës së largët të kaluar dhe, gjithashtu, nuk i kujtohet të ketë marrë ndonjë mandatpagesë nga firma, duke qenë se ka pasur njohje me administratorët e shoqërisë dhe nuk vinin në dyshim pagesat. Në mungesë të informacionit për pagesën e këtij kësti, në Kolegj është konsideruar si moment data 16.11.2006, bazuar në deklaratën e para fillimit të detyrës si inspektor i KLD-së, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar në ILDKPKI në këtë datë. Nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës rezulton se ka paguar gjatë vitit 2006 shumën 23.000 euro, nga të cilat 20.000 euro i ka marrë hua nga familjarët<sup>13</sup>, ndërsa 3.000 euro i ka disponuar nga kursimet e tij. Në lidhje me shumën 3.000 euro të paguar nga kursimet, NjShL-ja në Kolegj kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në datën 15.11.2006, e cila rezultoi me një balancë pozitive prej 360.934 lekësh. Në lidhje me pjesën tjetër të këstit prej 20.000 eurosh për blerjen e apartamentit, shumë të cilën subjekti i rivlerësimit e ka realizuar nëpërmjet huave marrë nga familjarët, trupi gjykues e gjen të drejtë konsiderimin nga Komisioni të huadhënësve, si persona tjerë të lidhur, për sa i përket këtij kontributi dhe, për pasojë, gjen të drejtë edhe konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës së deklaruar që ka shërbyer për pagesën e këstit të dytë për blerjen e apartamentit, objekt i këtij shkaku ankimi. Si

---

<sup>13</sup> 10.000 euro nga kunata e subjektit të rivlerësimit Sh. K.;  
5.000 euro nga vëllai i subjektit të rivlerësimit Xh. K.;  
3.000 euro nga kunati i subjektit të rivlerësimit E. S. (H.);  
2.000 euro nga shoku i subjektit të rivlerësimit N. T..

rrjedhë, në Kolegj u shqyrtuan huat, si dhe mundësia e dhënies së tyre nga personat e tjerë të lidhur si më poshtë.

**19.12.1. Huadhënia në vlerën 10.000 euro,** marrë hua nga kunata e subjektit të rivlerësimit, znj. Sh. K.. Trupi gjykues vëren se në pyetësorin standard të Komisionit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtetasja Sh. K. ka punuar për shumë vite me biznes privat në Përrenjas, disponon pasuri të regjistruara si 2 apartamente, 2 dyqane dhe 1 automjet, dhe se shuma e marrë hua është shlyer në vitet 2009-2010 (respektivisht 5.000 euro çdo vit). Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokumente për të provuar mundësinë e huadhënësës për të dhënë huan: (i) vërtetimin nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2019, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan, lidhur me të dhënat e Personit Fizik “Artikuj të ndryshëm industrialë”; (ii) certifikatë pronësie, datë 12.10.2004, për pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 20,64 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasit A. K.; (iii) certifikatë pronësie, datë 12.10.2004, për pasurinë e llojit “njësi”, me sip. 18,5 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasit A. K.; (iv) certifikatë pronësie, datë 12.01.2010, për pasurinë e llojit apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasit A. K.; (v) certifikatë pronësie, datë 18.06.2010, për pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 36,1 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasve A. dhe Sh. K..

**19.12.2. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për huan e marrë nga kunata e tij në shumën 10.000 euro,** pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion për të vërtetuar të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar, si dhe nga hetimi i Komisionit, personi tjetër i lidhur nuk rezulton të ketë gjeneruar të ardhura para vitit 2006. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë hua, ka argumentuar në shpjegimet e rezultateve të hetimit dhe në ankim se shtetasit Sh. dhe A. K. (kunata dhe baxhanaku i subjektit të rivlerësimit) kanë pasur mundësi ekonomike për të dhënë huan. Subjekti pretendon se ka paraqitur prova pranë Komisionit për të provuar sa më sipër, duke argumentuar në ankim se nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është kryer verifikimi se janë paguar rregullisht pagesat për sigurimet shoqërore, gjë që duhet të ishte kryer edhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Elbasan, duke mos kthyer një përgjigje negative.

**19.12.3. Kolegji vëren se Komisioni ka administruar shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2019,** të DRT-së Elbasan, sipas së cilës vërtetohet se ky subjekt tregtar nuk ka kryer asnjë deklaratë, nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe nuk ka deklaruar asnjë listëpagesë për kontributet shëndetësore. Subjekti, gjithashtu, ka paraqitur vërtetimin me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2020, të Bashkisë Përrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, sipas së cilit vërtetohet se Personi Fizik “Sh. K.” është regjistruar pranë organeve të qeverisjes vendore, Bashkia Përrenjas, me aktivitet “Artikuj të ndryshëm industrialë” dhe nga verifikimi i kryer rezulton se ky subjekt tregtar ka paguar të gjitha detyrimet dhe taksat vendore për qarkullim të xhiros deri në shumën 2.000.000 lekë. Subjekti tregtar, sipas kësaj shkrese, është regjistruar në datën 13.01.2001 dhe është çregjistruar në datën 24.10.2008.

**19.12.4. Përveç sa më sipër,** Komisioni analizoi, gjithashtu, të ardhurat e subjektit tregtar “Sh. K.” Person Fizik, duke filluar nga marsi i vitit 2001 deri në tetor të viti 2006. Bazuar në natyrën e aktivitetit dhe rajonin ku është zhvilluar, Komisioni vlerësoi se shuma e fitimit *neto* nga aktiviteti tregtar t’i përlllogaritet 20% e qarkullimit, për të cilin janë paguar detyrimet tatimore përkatëse të konfirmuara nga organet tatimore. Nga kjo analizë rezultoi se shuma e fitimit *neto* është pothuajse e barabartë me shpenzimet jetike të familjes së huadhënësës, për rrjedhë Komisioni vlerësoi se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme në dispozicion, për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit në shumën 10.000 euro, në vitin 2006. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi konkluzionin e Komisionit, lidhur me



pamundësinë e znj. Sh. K. për të dhënë huan, me arsyetimin se ka pasur një aktivitet privat të regjistruar në institucionet shtetërore, për të cilën ka paguar detyrimet tatimore, por pa argumentuar dhe provuar mundësinë e burimeve financiare të ligjshme për t'i dhënë huan subjektit të rivlerësimit.

Si rrjedhojë e sa më sipër, nga të gjithë dokumentet e administruara në dosjen e subjektit të rivlerësimit, nuk gjendet informacion mbi të ardhurat që ka gjeneruar nga aktiviteti si person fizik, znj. Sh. K.. Të dhënat për pagesën e sigurimeve shoqërore tregojnë vetëm pagën mbi të cilët është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore që nga viti 2005. Në përfundim, trupi gjykues vëren se nuk rezulton e provuar se huadhënësja, znj. Sh. K., kishte mundësi me burime financiare të ligjshme për dhënien e huas prej 10.000 eurosh subjektit të rivlerësimit, për kryerjen e pagesës së këstit të dytë për blerjen e apartamentit.

**19.13.** *Lidhur me huan në vlerën 5.000 euro*, marrë nga vëllai i subjektit Xh. K., në pyetësozin standard, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e vëllait si kuzhinier në Librazhd dhe në Greqi, si dhe nga shitja e apartamentit në Librazhd. Shuma e marrë hua është shlyer nga subjekti në vitet 2007-2008 (respektivisht vlera 3.000 euro në vitin 2007 dhe vlerat 2.000 euro në vitin 2008). Komisioni i kaloi barrën e provës për huan në vlerën 5.000 euro nga vëllai i subjektit, pasi dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, daton pas vitit (2006) të dhënies së huas. Më tej, subjekti shpjegoi se vëllai i tij ka punuar si kuzhinier në {\*\*\*} Librazhd dhe në hotel “{\*\*\*}” Librazhd, disa vite në lokalin e ndërtuar nga babai i subjektit në Librazhd, ka punuar në {\*\*\*}, Halkidiki, Greqi, në një zonë turistike, si dhe pasi është larguar nga Greqia vazhdon të punojë si kuzhinier në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision një deklaratë të Xh. K.t, e cila nuk është hartuar para noterit, që mban datën 04.07.2020, ku specifikohet nga deklaruesi se i ka dhënë hua vëllait të tij shumën 5.000 euro nga të ardhurat e tij nga punësimi si kuzhinier. Ky dokument me bazë vetëdeklarimi, i hartuar personalisht nga vëllai i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, nuk përmban të dhëna nga të cilat mund të përfshihen në analizën financiare si të ardhura të kursyera, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, përveçse deklaratën nga huadhënësi që ia ka dhënë shumën 5.000 euro vëllait të tij, ndaj fuqia e saj provuese lidhur me realizimin e këtyre të ardhurave nuk është bindëse dhe, për më tepër, nuk mbështetet nga asnjë dokument tjetër i administruar në dosje.

**19.13.1.** Kolegji vëren se lidhur me këtë hua të pretenduar se është marrë nga vëllai Xh. K., subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se ka paraqitur në Komision dokumentacion për të provuar se vëllai i tij ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të dhënë huan, duke qenë se ka punuar për një kohë të gjatë si kuzhinier në Librazhd, në Greqi dhe Tiranë. Nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti i rivlerësimit, i cili është administruar në dosjen e Komisionit, konstatohet se ka paraqitur kontratë shitblerjeje apartamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.07.2008, me palë shitëse Xh. K. dhe palë blerëse N. C., për apartamentin me sip. 40,40 m<sup>2</sup>, me çmim shitje 1.500.000 lekë, ndodhur në Librazhd (bashkëlidhur certifikata e pronësisë). Nga ky dokumentacion konstatohet se shitja e apartamentit të vëllait të subjektit të rivlerësimit është kryer në vitin 2008, ndërkohë pretendohet se vëllai i subjektit i ka dhënë huan 5.000 euro subjektit në vitin 2006, dy vjet përpara se të krijonte të ardhurat nga shitja e apartamentit, ndaj për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat nga shitja e apartamentit të Xh. K. nuk mund të konsiderohen se kanë shërbyer si burim për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, si rrjedhojë nuk mund të përfshihen në analizën financiare të vitit 2006.

**19.14.** *Lidhur me vlerën 3.000 euro të dhënë hua nga kunati i subjektit E. S. (H.), subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion për të provuar të ardhurat e kunatit të tij, i cili përbëhet nga dokumente në gjuhën greke, të cilat duken se kanë lidhje me rezidencën e kunatit të subjektit në Greqi. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se nuk është formalisht i rregullt, pasi nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, si dhe nuk mban vulën apostile. Nga verifikimi i deklaratave periodike të administruara në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar detyrimin e vlerës prej 3.000 eurosh në DIPP-në e vitit 2006 e, më tej, edhe shlyerjen e saj në deklaratën periodike të vitit 2008.*

Si rrjedhojë të sa më sipër, duke mos pasur në dispozicion dokumentacion, i cili mund të provojë të ardhurat e kunatit të subjektit të rivlerësimit apo ky dokumentacion të jetë i paraqitur sipas formës së kërkuar nga ligji, trupi gjykues vlerësoi që në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat nga huaja e E. S..

**19.15.** *Lidhur me huan në vlerën 2.000 euro të marrë nga shoku i subjektit të rivlerësimit N. T., subjekti ka pretenduar në Komision dhe në ankim se z. T. ka disa biznese në qytetin e Librazhdit. Nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar detyrimin e shumës prej 2.000 eurosh në DIPP-në e vitit 2006 e, më tej, edhe shlyerjen e saj në deklaratat periodike përkatëse, konkretisht, vlerën 1.000 euro në deklaratën e vitit 2007 dhe vlerën 1.000 euro në deklaratën periodike të vitit 2008. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për huan në vlerën 2.000 euro nga shtetasi N. T., pasi subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion për të provuar të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i këtij individ, si dhe nga hetimi i Komisionit rezultoi se shoqëria tregtare, ku ky shtetas është administrator dhe ortak i vetëm, është themeluar pas dhënies së huas (viti 2006).*

**19.15.1.** Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan<sup>14</sup>, sipas së cilës rezulton se z. T. është administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Në ekstraktin historik në faqen zyrtare të QKB-së, Komisioni ka evidentuar se kjo shoqëri është themeluar sipas Aktit të Themelimit të shoqërisë në datën 30.11.2006, në një kohë që huaja është marrë më 16.11.2006, por në këtë ekstrakt të gjendjes së regjistrimit të subjektit tregtar, data e regjistrimit të aktivitetit rezulton më 03.03.1998. Nisur nga këto rrethana, vlerësohet se kjo datë është regjistrimi i personit fizik i subjektit tregtar dhe në vitin 2006 ka marrë statusin juridik të këtij subjekti, por një konstatim të tillë nuk e ka pretenduar subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pavarësisht se shuma e dhënë hua është relativisht e vogël nuk rezultojnë të dhëna për fitimet e këtij subjekti tregtar nga viti 1998, sipas regjistrimit në QKB, si rrjedhojë mbetet e paprovuar mundësia financiare e huadhënësit N. T. për të dhënë hua shumën 2.000 euro.

**19.15.2.** Subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e rezultateve të hetimit, për të provuar të ardhurat e N. T. për dhënien e huas në vlerën 2.000 euro, ka paraqitur deklaratën noteriale të këtij të fundit, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.06.2020, sipas së cilës deklaruesi sqaron se i ka dhënë në formën e deklaratës verbale subjektit të rivlerësimit shumën 2.000 euro, të cilën ia ka kthyer me dy këste, 1.000 euro në vitin 2007 dhe 1.000 euro në vitin 2008. Lidhur me të ardhurat e tij nuk ka deklaruar të dhëna, gjithashtu edhe subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument pas kalimit të barrës së provës për ta provuar mundësinë e huadhënies. Lidhur me deklaratën noteriale të huadhënësit, duhen pasur në konsideratë qëndrimet<sup>15</sup> që ka mbajtur Kolegji në çështje të

<sup>14</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2019.

<sup>15</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6/2018(JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

ndryshme, sipas së cilave, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë dhe për shkak të procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

**19.15.3.** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim mbi gjendjen kreditore të llogarisë bankare të huadhënësit në shumën 10.000,38 euro dhe shumën 5.338,38 euro, nga konsultimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton gjendja e llogarisë bankare të N. T., për periudhën 23 janar 2006 - 24 shkurt 2006, në “Tirana Bank”, e cila është në monedhën lekë dhe gjendet që subjekti i rivlerësimit pretendon të jenë në euro, janë në lekë. Kolegji konstaton se gjendja e llogarisë bankare në datën 10.02.2006 është në balancën 10.000,38 lekë, ndërsa në datën 24.02.2006 llogaria ka gjendje 5.338,38 lekë. Pra, shifrat janë të njëjta me ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa ndryshon valuta nga euro që pretendon subjekti në lekë që rezulton të jetë gjendja faktike e këtyre llogarive, dukshëm një diferencë e madhe vlerash, sipas gjendjes së të cilave shumat në lekë nuk mbulojnë vlerën e dhënë hua nga shoku i subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbeti e paprovuar mundësia financiare e huadhënësit N. T. për dhënien e huas në shumën 2.000 euro, kjo se nuk u paraqit asnjë dokument nga subjekti i rivlerësimit, i cili kishte barrën e provës për të provuar mundësinë e dhënies së huas nga ky shtetas nga burime financiare të ligjshme.

**19.16.** Lidhur me pagesën e këstit të fundit në shumën 5.000 euro, të kryer nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, Komisioni ka konstatuar se deri në datën 31.12.2007, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme në shumën 1.046.324 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive. Nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit nëpërmjet NjShL-së, analiza financiare për subjektin dhe familjen e tij për vitin 2007, rezultoi se situata financiare për vitin 2007 është me balancë negative në vlerën 826.050 lekë, si rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e huas në vlerën 5.000 euro, si dhe për të paguar huat e pretenduara të shlyera në këtë vit për këtë diferencë negative.

**19.17.** Në përfundim të këtij shkaku ankimi, Kolegji vëren se u analizuan deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratat periodike të viteve 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar pakësime apo shtesa të vlerës prej 1.000.000 lekësh, të cilën e ka deklaruar në deklarin e para fillimit të detyrës së vitit 2003. Në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, sipas së cilave ka sqaruar se ka qenë një harresë njerëzore, është një situatë faktike, e cila pamundëson kontrollin e rrjedhjes së gjendjes së *cash-it* ndër vite, duke devijuar edhe analizën financiare me alternativa të ndryshme. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarin të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhë mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor.

Forma e deklaramit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar i cili duhet respektuar.

**19.18.** Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, analiza financiare e kryer nga NjShL në Kolegj, për mundësinë e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit prej 32.000 eurosh në deri në datën 12.10.2005, rezultoi me mangësi burimesh financiare të ligjshme në diferencën negative prej 1.849.738 lekësh. Lidhur me mundësinë e shlyerjes së këstit të dytë prej 23.000 eurosh në vitin 2006, nga i cili 3.000 euro subjekti i rivlerësimit kishte mundësi t'i kursente, ndërsa 20.000 euro është shuma që përbën huat, për të cilat, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit nuk provoi se personat e tjerë të lidhur në cilësinë e huadhënësve kishin mundësi për të dhënë huat përkatëse nga të ardhura me burime të ligjshme. Sa i përket këstit të fundit prej 5.000 eurosh të paguar në vitin 2007 për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një diferencë negative në shumën 826.050 lekë. Si rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, për blerjen e apartamentit me sip. 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e kësteve, në kuptim të neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20.** *Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë me çmimin 200.000 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, konstatimi i Komisionit se nuk janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit është i gabuar sepse, sipas tij, mbartin detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat individët rezidentë të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit. Meqenëse subjekti nuk gjendet në kushtet e subjekteve që përfitojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë, atëherë sipas tij vlera e fituar nga shitja e automjetit në shumën 100.000 lekë duhet të konsiderohet si e ligjshme. Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi ka sqaruar se deklaratave periodike nuk i ka dhënë mjaftueshëm rëndësi ndër vite.*

**20.1.** *Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: [...]shuma prej 100.000 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare.*

**20.2.** *Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa {\*\*\*}, blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.09.2005, me palë shitëse J. K., nipi i baxhanakut të subjektit, me çmimin 200.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale, sipas kësaj kontrate. Me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.08.2013, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë automjet palës blerëse A. D., me çmimin 300.000 lekë, likuiduar cash jashtë zyrës noteriale.*

**20.3.** *Nga dokumentacioni i gjendur në dosjen e ILDKPKI-së, e administruar në dosjen e Komisionit, konstatohet se në deklaratën vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin si vijon: Blerë autoveturë “Mercedes Benz”, tipi 124 me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.09.2005, shitësit J. K., nipi i baxhanakut A. K., me kursimet e familjes, vlera 200.000 lekë. Shitur kjo autoveturë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.08.2013, blerësit A. D., në vlerën 300.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2005 dhe as në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2006. Për herë të parë subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit në DIPP-në e vitit 2006, me të dhënat: automjet tip “Mercedes Benz”, prodhim i vitit 1988, me targa {\*\*\*}, në vlerën 200.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2013, deklaroi shitjen e këtij automjeti në vlerën 300.000 lekë. Nga përlllogaritja*

e datave të shitblerjes, sipas kontratave, ky automjet rezulton se është shitur pas 8 vitesh në vlerë më të lartë se ajo e blerjes.

**20.4.** Lidhur me këto gjetje cituar më sipër, me pyetësin nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë faktin e rritjes së vlerës së këtij automjeti me 50 %, pas 8 vitesh përdorim. Në përgjigjet datë 25.02.2020 të pyetësit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Ky automjet është blerë nën vlerën e tregut, pasi do të blihej nga baxhanaku i tij, A. K., por për shkak se ai e kishte një automjet, ia kërkova që ta blija unë, pasi nuk posedoja automjet. Duke qenë se ky automjet i ishte premtuar A. K. në këtë çmim, nga nipi i tij, nën vlerën e tregut, atëherë me të njëjtin çmim këtë automjet e bleva unë. Në lidhje me gjendjen e mjetit ai në shitje ka qenë pothuajse si në blerje, për shkak se e kam përdorur shumë pak duke qenë se banoja në Tiranë dhe punoja në KLD, ku përdorimi i automjetit nuk ishte i nevojshëm.*

**20.5.** Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit pasi: (i) subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit blerjen e automjetit në DIPP-në e vitit 2005 dhe as në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2006; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit në shumën 100.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se: *[...] në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 4 e nenit 13 të tij, individët nën kufirin 2 milionë lekë në vit, janë të përjashtuar nga plotësimi dhe dorëzimi i deklaratës vjetore për të ardhurat e realizuara. Nga interesimi pranë noterëve dhe organeve tatimore, asnjë shtetas, individ rezident nuk ka pasur dhe nuk e ka detyrim pagesën e tatimit mbi të ardhurat si në rastin e shitjes së automjetit me një fitim prej 100.000 lekësh, pasi të ardhurat e realizuara nuk e kalojnë kufirin e 2 milionë lekëve në vit. Për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar në shumën 100.000 lekë duhet të vlerësohet si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihet në tabelën financiare [...]. Këtë argument subjekti i rivlerësimit e ka parashtruar edhe në ankimin e paraqitur prej tij.*

**20.6.** Në lidhje me mundësinë financiare të blerjes së këtij automjeti, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizë financiare të Komisionit, rezulton se është i drejtë konkluzioni se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive për vitin 2005, për diferencën negative në shumën 1.661.523 lekë. Lidhur me mosdeklarimin e blerjes së automjetit në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet e deklarimit detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e interesave private pasurorë të vitit 2005 kontratën e shitblerjes së automjetit, deklarim të cilin e ka kryer një vit me vonesë në vitin 2006. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shitblerjen e këtij automjeti edhe në deklaratën *vetting*, duke vlerësuar se këto janë rrethana të konstatuara, prej të cilave subjekti nuk ka pasur si qëllim mbulimin e ndonjë situatë të dyshimtë, si rrjedhojë kjo pasaktësi e evidentuar nuk mund të kualifikohet në ndonjë nga situatat që parashikon neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**20.7.** Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit nuk konstatohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti mes çmimit të shitjes (300.000 lekë) dhe çmimit të blerjes (200.000 lekë). Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në shkaqet e ankimit, se është i gabuar konstatimi i Komisionit se nuk janë paguar detyrimet

tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, pasi mbartin detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat individët rezidentë të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit, vlerësohet nga Kolegji si i pabazuar në ligj, por në kushtet kur nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një balancë pozitive për vitin 2013, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë peshën e kësaj shume në vlerësimin e pasurisë dhe problematikave të çështjes, vlerësoi pa ndikim në vendimmarrje konsiderimin ose jo si të ardhur të ligjshme të shumës prej 100.000 lekësh, në cilindo version që ajo do të kualifikohej dhe, për këtë arsye, e gjeti të panevojshëm trajtimin më tej të këtij shkak ankimi.

21. *Lidhur me automjetin tip “Volkswagen”, me targë {\*\*\*}, blerë me çmimin 8.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se me provat që ka paraqitur në Komision ka arritur të provojë dyshimet që lidhen me çmimin e blerjes së këtij automjeti. Subjekti ngre pretendimin se Komisioni nuk ka kryer mjaftueshëm hetim dhe provat e dorëzuara prej tij nuk i ka bërë pjesë të arsytimit dhe të vendimit objekt shqyrtimi, si dhe nuk ka analizuar kontratën e lidhur mes palëve, rrethanë që subjekti pretendon të merret në shqyrtim nga Kolegji, duke riçelur shqyrtimin gjyqësor. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk ka qenë zgjedhje e mirë për shkak të defekteve të shumta dhe të njëpasnjëshme, kjo për shkak se është blerë me mbi 230.000 km të kryera nga ky mjet.*

21.1. Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive gjatë vitit 2017.*

21.2. Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar automjeti me targë {\*\*\*}, të cilin e ka blerë nga shtetasi K. S., nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.04.2017, me çmimin 8.000 euro. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2017.

21.3. Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, se duket i dyshimtë çmimi i blerjes së automjetit, pasi shtetasi K. S., i cili duket se merret me tregti automjetesh, e ka shitur me të njëjtin çmim që e ka blerë në Gjermani (8.000 euro), duke mos i shtuar çmimit të shitjes as shpenzimet doganore dhe të transportit (në total 293.179 lekë) dhe as ndonjë fitim të mundshëm, konsideruar këtu edhe periudhën e shkurtër 4-mujore, që nga data e blerjes deri në datën e shitjes. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se: *[...] ky mjet ka rezultuar me defekte dhe i është dashur t'i riparojë ato për ta bërë mjetin funksional. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti dorëzoi deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 23.06.2020, lëshuar nga shtetasi K. S., i cili shprehet se këtë mjet e ka marrë me defekte, me mendimin se do ta riparonte me kosto të ulët, gjë e cila nuk ishte e mundur dhe vendosi ta shiste me çmim më të ulët nga sa i kishte kushtuar.*

21.4. Komisioni vlerësoi se duke qenë se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë automjet në datën 08.04.2017 dhe, më tej, ka kryer udhëtime jashtë Shqipërisë, respektivisht: (i) në datën 13.05.2017 ka udhëtuar drejt Strugës; (ii) në datën 21.05.2017 ka udhëtuar drejt Shkupit; (iii) në datën 23.09.2017 ka udhëtuar drejt Ulqinit; si dhe (iv) udhëtime të tjera gjatë vitit 2018, tregon se automjeti ka qenë në gjendje funksionale, çka rrëzon pretendimet e subjektit për defekte.

21.5. Kolegji vëren se nga analiza e fakteve më sipër, rezulton se Komisioni ka kryer analizë financiare për subjektin e rivlerësimit për sa i përket blerjes së automjetit tip “Volkswagen” pas vitit 2016 (08.04.2017), pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Në këtë kontekst, bazuar në kuadrin

ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramëve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës *vetting*. Nga praktika e konsoliduar e Kolegjit është mbajtur qëndrim<sup>16</sup> se kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për vitet pas deklarimit *vetting*, kryhet nga ILDKPKI-ja, pasi duke qenë subjekt deklarimi i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm, për shkak të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

**21.6.** Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit pas dorëzimit të deklaratës *vetting* mund të kishte relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Konkretisht, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016 me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni ose Kolegji në kushtet kur krijohet dyshimi për deklarim të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën *vetting*. Në rrethanat konkrete, nga analiza e akteve në fashikull dhe përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, nuk rezulton që Komisioni të jetë gjendur në këto kushte apo në rrethana të tjera të cilat të jenë arsyetuar se justifikojnë analizën financiare për periudhën pas deklarimit *vetting*. Në vendimin e Komisionit nuk pasqyrohet asnjë arsye që ka bërë të nevojshme kryerjen e analizës financiare për blerjen e këtij automjeti. Meqenëse konstatimet e Komisionit nuk janë trajtuar në drejtim të pamundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit, pamundësi e cila afekton periudhën para deklarimit *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo çështje, e cila i përket periudhës pas deklarimit në deklaratën *vetting*, nuk përbën shkaqe nga ato që mund t’i nënshtrohen shqyrtimit në Kolegji.

**22.** *Lidhur me të ardhurat si ekspert në Brindisi, Itali*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar nga nxitimi 1.197 euro në vend të deklaronte 1.106,7 euro, të cilat i ka përfituar realisht nga puna e tij si ekspert në Brindisi. Sipas subjektit të rivlerësimit rezulton se nga tatimi mbi të ardhurat janë të përjashtuar të gjithë individët të cilët nuk realizojnë të ardhura mbi vlerën 2.000.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, për këtë arsye, vlera e përfituar në Brindisi duhet të përfshihet në analizën financiare, duke e konsideruar si të ardhur të ligjshme. Subjekti pretendon se nuk ka informacion nëse është paguar tatimi në shtetin Italian nga ana e organizatorëve, por për verifikimin e këtij fakti sugjeron që të kryhen verifikimet nëpërmjet përfaqësuesve të ONM-së. Subjekti pretendon se është në kushtet kur nuk mund të provojë nëse tatimi është paguar apo jo.

**22.1.** Konkluzionet e Komisionit për këtë të ardhur: *Për sa kohë nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar, vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, si konkluzion, shuma prej 1.106,70 euro, nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare.*

**22.2.** Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesë si ekspert në Brindisi, Itali, në vitin 2008, sipas nxjerrjes së llogarisë nga “Raiffeisen Bank” [...] vlera 1.197 euro.*

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Shpërblim nga Dhoma e Tregtisë e Brindisit Itali, i ftuar në cilësinë e ekspertit në prill 2008 [...] 1.000 euro.*

---

<sup>16</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 8/2021 (JR), datë 09.03.2021, paragrafi 26.3.

Në dosjen e Komisionit gjendet i administruar dokumentacion nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit konstatohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma 1.106,70 euro (dhe jo 1197 euro që është deklaruar në deklaratën *vetting*) në datën 17.06.2008, nga {\*\*\*} me përshkrimin: “*Compenso docenza e rimborso spese corso guida storico culturale naturalistica*”. Referuar këtij përshkrimi, Komisioni vëren se shuma e transferuar ka të bëjë jo vetëm me pagesën për mësimdhënie, por edhe për kompensim shpenzimesh.

**22.3.** Komisioni ka konstatuar se referuar legjislacionit tatimor mbi të ardhurat personale, konkretisht, nenit 3 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe pikës 1.3 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, subjekti i rivlerësimit vlerësohet *si rezident tatimor shqiptar*, pasi përmbush kriterin e kohëzgjatjes së qëndrimit në Shqipëri për më shumë se 183 ditë gjatë vitit tatimor objekt shqyrtimi (viti 2008). Në këtë kuptim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt detyrimesh tatimore mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, me të vetmen rezervë rastet kur janë të zbatueshme marrëveshje ndërkombëtare për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit fiskal.

**22.4.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me faktin se nuk ka dokumentacion ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri dhe se mbart detyrimin të provojë se ky tatim është paguar në shtetin italian. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës, sqaroi se: [...] bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8, “E ardhura e tatueshme”, mbartin detyrimin e deklaramit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga individët rezidentë vetëm ata, të cilët realizojnë të ardhura mbi 2.000.000 lekë në vit. Gjithashtu, subjekti kërkoi të merren në konsideratë përcaktimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84 /2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: *Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.* Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, gjithashtu, se e kishte të pamundur të marrë përgjigje nga shteti italian për të provuar nëse tatimi është mbajtur në burim apo jo, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19.

**22.5.** Nga deklarata *vetting* vërehet se subjekti ka deklaruar si të ardhur vlerën 1.197 euro, e cila është balanca e llogarisë në datën 17.06.2008, pas kreditimit të llogarisë në vlerën 1.106,7 euro. Në lidhje me këtë shkak ankimi, në dosjen e administruar në Komision, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka paraqitur një komunikim me mesazhe në gjuhën italiane, mes subjektit dhe mikut të tij në Itali, ku ky i fundit pyetet nga subjekti nëse për shumën prej 1.106,7 euro janë paguar tatimet për këto të ardhura. Me dokumentacionin që disponohet nuk ka një përgjigje lidhur me pyetjen e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit. Një tjetër dokument i administruar në dosje është edhe një urdhër transfertë, fotokopje e Bankës Popullore në Puglia, dokument i cili është në gjuhën italiane dhe jo në formën e kërkuar nga ligji. Në këtë dokument mund të kuptohet se për subjektin e rivlerësimit janë transferuar 1.126,9 euro për kompensim mësimdhënie dhe shpenzimesh. Në llogarinë e subjektit kanë mbërritur 1.106,7 euro, shumë më e vogël se ajo e përfituar, nga ku mund të kuptohet se diferenca është mbajtur për komisione transferte.



22.6. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji çmoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet ku nuk provoi që për të ardhurat e realizuara nga puna si ekspert në Brindisi, Itali, të jenë paguar detyrimet tatimore. Subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për ta zbuluar këtë fakt, pavarësisht se mbrohet me argumentin se nuk kishte detyrim për pagimin e tatimeve, pasi nuk është subjekt me të ardhura mbi 2.000.000 lekë. Kolegji vlerëson se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga subjekti në cilësinë e ekspertit, sipas këtij shkak ankimor, është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimi, të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit si ekspert në Brindisi, për sa kohë nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si e ardhur e cila i është provuar me dokumentacion, shpjeguar bindshëm burimi, është deklaruar dhe për të cilën është paguar detyrimi tatimor, vlera prej 1.106,70 eurosh, nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare. *Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.*

23. *Lidhur me analizën financiare*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se ka kryer disa pasaktësi në plotësimin e deklaratave periodike lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, ku për vitet 2004-2010 ka harruar të bëjë deklaratimet vjetore për kursimet e tij dhe të bashkëshortes. Sipas subjektit këto kursime kanë shërbyer për pagesën e kështit dhe për të shlyer huat e marra. Subjekti i rivlerësimit pretendon se referuar të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes ka pasur mundësi për të krijuar këto kursime. Subjekti, në përfundim të këtij shkak ankimi, kërkon të rishikohet analiza financiare për vitet 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2014. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit, subjekti pretendon se vlera 500.000 lekë nuk është e paarsyeshme, por e mjaftueshme për mobilimin e apartamentit, duke qenë se një pjesë të mirë të orendive i ka sjellë nga Librazhdi, duke pretenduar mos të përllogaritet si shpenzim i njëhershëm, por të shtrihet për një periudhë 10-vjeçare, pasi në momentin që ka blerë apartamentin nuk ka kryer shpenzime për mobilimin, meqenëse kishin prioritet shlyerja e kësteve të apartamentit. Subjekti i rivlerësimit ankimon shpenzimet e udhëtimit për periudhën 23.09.2006-26.09.2006, duke pretenduar se këto shpenzime janë mbuluar nga një shtetas Italian dhe sipas subjektit e ka provuar një pretendim të tillë.

23.1. *Konkluzionet e Komisionit: Pas kalimit të barrës së provës dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ripërllogariti të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti ndodhet me një balancë negative prej 5.068.298 lekësh për të justifikuar të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e krijuara.*

*Për sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të germës "b", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.*

23.2. Kolegji nëpërmjet NjShL kontrolloi analizën financiare të Komisionit, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në dosje, sipas së cilës rezultoi si më poshtë.

23.3. Nga analiza financiare e kryer për vitin 2005, për subjektin e rivlerësimit rezultoi se nuk ka deklaruar si burim përdorimin e gjendjes *cash* në shumën 1.000.000 lekë, për pagesën e kështit të parë prej 32.000 eurosh për blerjen e apartamentit me sip. 98 m<sup>2</sup>, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se në deklaratën *vetting* si burim për

pagesën e këtij kësti ka shënuar “kursime nga familja”, nuk ka specifikuar se në këto kursime përfshihet edhe gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2003, për të cilën nuk ka deklaruar në deklaratat periodike pasardhëse as shtim e as pakësim. Në këto kushte u gjet i drejtë vendimi i Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumës 1.000.000 lekë, si burim për krijimin e kësaj pasurie, si rrjedhojë është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në shumën 1.661.523 lekë për të krijuar pasuritë<sup>17</sup> në vitin 2005, si dhe për të krijuar kursimet dhe përballuar shpenzimet e kryera gjatë këtij viti.

**23.4.** Për vitin 2006, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime dhe as shtesa e pakësime të likuiditeteve *cash*, si rrjedhojë pagesa e këstit të dytë 23.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 98 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nga të cilat 20.000 euro i ka marrë hua dhe 3.000 euro i ka paguar nga kursimet e tij, është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti rezulton me një diferencë negative në shumën 2.195.685 lekë për pagesën e këstit për blerjen e apartamentit, si dhe përballimin e shpenzimeve të kryera gjatë këtij viti.

**23.5.** Për vitin 2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte të ardhura të mjaftueshme, për të përballuar pagesën e këstit të fundit për blerjen e apartamentit, të përballonte shpenzimet e jetesës për këtë vit, si dhe të shlyente huat ndaj të afërmeve, për një diferencë negative në vlerën 826.050 lekë. Kjo diferencë negative krahasuar me diferencën e rezultuar në Komision prej 1.046.324 lekësh, është më e ulët si pasojë e moskonsiderimit si shpenzim nga subjekti i rivlerësimit të punimeve të papërfunduara nga shoqëria e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën 1.480 euro dhe përdorimit të një kursi<sup>18</sup> këmbimi të ndryshëm nga euro në lekë.

**23.6.** Për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të përballuar pagesat e shlyerjes së huave, që kanë shërbyer për pagesat e blerjes së apartamentit, si dhe të përballonte shpenzimet e jetesës për këtë vit, për një diferencë negative në vlerën 63.675 lekë. Kjo diferencë negative krahasuar me diferencën e rezultuar në Komision prej 65.948 lekësh, është më e ulët si pasojë e përdorimit të një kursi<sup>19</sup> këmbimi më të ulët nga euro në lekë.

**23.7.** Për vitin 2014, rezulton se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe përballimin e shpenzimeve të kryera në këtë vit për një diferencë negative në vlerën 98.819 lekë.

**23.8.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka kundërshtuar në ankimin e tij faktin e përfshirjes në analizën financiare të Komisionit të shpenzimeve për pagesat e kryera për kthimin e huave të marra për pagesën e çmimit të apartamentit të banimit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me pretendimin se për sa kohë Komisioni i ka konsideruar huat me mungesë burimi të ligjshëm nuk duhet t’i përfshinte shumat për shlyerjen e tyre në analizën financiare. Trupi gjykues vlerëson se kontrolli i ligjshmërisë së burimeve të huave është bërë në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në momentin e blerjes së saj, kurse analiza financiare e shpenzimeve ka si qëllim të verifikojë nëse shpenzimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike në vitet

---

<sup>17</sup> Pagesën e këstit të apartamentit prej 32.000 eurosh, si dhe automjetin tip “Mercedes Benz” blerë me çmimin 200.000 lekë.

<sup>18</sup> Në Kolegj është përdorur kursi mesatar vjetor i këmbimit për vitin 2007, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë, ndërsa nga Komisioni për konvertimet nga euro në lekë është përdorur kursi mesatar i këmbimit për muajin dhjetor 2007 sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë:

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

<sup>19</sup> Në Kolegj është përdorur kursi mesatar vjetor i këmbimit për vitin 2008, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë, ndërsa nga Komisioni për konvertimet nga euro në lekë është përdorur kursi mesatar i këmbimit për muajin dhjetor 2008, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë.

pasuese janë përballuar ose jo me burime të ligjshme. Në këtë rast problematikat nuk trajtohen si të mbivendosura me njëra-tjetrën, por analizohen nga dy optika krejt të ndryshme, në funksion të qëllimit për të vlerësuar në mënyrë të gjithanshme besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

**23.9.** Lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësozin nr. 1 të Komisionit se këto shpenzime dhe pajisjet elektrike janë realizuar në një periudhë 10-vjeçare, në vlerën rreth 500.000 lekë. Kolegji vlerëson se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në fund të tetorit të vitit 2006 dhe se shpenzimet e kësaj natyre nuk mund të jenë kryer në një periudhë 10-vjeçare, bazuar në arsyetimin se pjesa më e madhe e shpenzimeve të mobilimit përfshirë pajisjet elektrike kryhen përpara ose në fillimet e banimit. Për sa më sipër, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument për të provuar deklaratimet dhe pretendimet e tij, duke e bërë të besueshëm faktin se këto shpenzime janë kryer në vitet 2006 dhe 2007, ndaj konkluzioni i Komisionit, sa i përket shpërndarjes së shpenzimeve të mobilimit në dy vitet e para të banimit të subjektit në këtë apartament, gjendet i drejtë dhe i bazuar, duke dhënë si rrjedhojë efektet financiare në analizë, pikërisht në këto dy vjet.

**23.10.** Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në Itali në periudhën 23.09.2006-26.09.2006, subjekti ka pretenduar se nuk ka shpenzuar nga të ardhurat e tij, duke qenë se këto shpenzime janë mbuluar nga ortaku i mikut B. V., si dhe qëndrimi ka qenë te miku italian, M. C.. Subjekti ka dorëzuar një deklaratë personale jo noteriale të B. V., në të cilën ky individ shpjegon se ka udhëtuar drejt Italisë për arsye shëndetësore dhe subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar për ta asistuar në përkthimin e gjuhës italiane.

Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo deklaratë personale nuk mbart vlerë provuese në këtë proces, pasi është hartuar nga deklaruesi për t'i shërbyer procesit të rivlerësimit të subjektit dhe nuk provon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të subjektit ndaj, për këtë arsye, shpenzimet e këtij udhëtimi u morën të pandryshuara nga shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni për këtë udhëtim.

**23.11.** Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit, lidhur me analizën financiare të viteve 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2014, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ecurinë e gjendjes *cash* të këtyre viteve në deklaratimet periodike përkatëse. Nga praktika<sup>20</sup> e konsoliduar e Kolegjit, rezulton se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, varianti fillestar i pandryshuar, në nenin 4, germa “d”, parashikon se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratimet e interesave private dhe pasurorë të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasaktësitë kanë ardhur për shkak të harresës është i pabazuar, pasi rezulton se ato shoqërohen me mungesën e provueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, ndaj nuk mund të konsiderohen thjesht si pasaktësi. Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se për analizën financiare të kryer në Kolegji subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në kuptim

---

<sup>20</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 20/2020, datë 08.09.2020, paragrafi 19.4.

të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. *Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet i bazuar.*

### ***Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës***

24. *Për kriterin e figurës*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se vendimmarrja e Komisionit nuk është e bazuar, pasi në seancën dëgjimore në Komision u deklarua nga trupi gjykues se për subjektin e rivlerësimit ka informacion për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, të cilat cenojnë figurën e tij dhe në përfundim në vendim, po i njëjti trup gjykues, ka konkluduar se nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk u arrit të vërtetohet përfshirja e tij në veprimtari korruptive, në vlerësimin tërësor gjen të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, rrethanë e cila mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut te drejtësia. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni tregon njëanshmëri në vendimmarrjen e tij, kur e sheh me rezervë faktin që subjekti nuk ka pasur dijeni për procedimin penal 114/2019. Kjo padijeni ka ardhur si pasojë se procedimi penal ka qenë i regjistruar për persona të tjerë ose pa autor, si rrjedhojë subjekti pretendon se nuk është thirrur e as pyetur për ndonjë fakt apo rrethanë të këtij procedimi penal, duke u informuar për të, vetëm kur i është vënë në dispozicion materiali i Komisionit, aq më tepër që ky procedim penal është pushuar.

24.1. Arsytimi i Komisionit për kriterin e figurës: “Gjatë hetimit të Komisionit nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk u arrit të vërtetohet përfshirja e tij në veprimtari korruptive në pozicionin e anëtarit apo kryesuesit të trupit gjyqësor në proceset gjyqësore. Megjithatë, Komisioni arrin të shohë me rezervë faktin që subjekti nuk ka pasur dijeni për procedimin penal të nisur ndaj tij, si dhe dëshmitë kontradiktore të dhëna prej tij dhe prokurorja e thirrur në cilësinë e dëshmitares dhe megjithëse nuk arrin në një përfundim në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri, do të shprehet nëpërmjet ndikimit prej tij në vlerësimin tërësor që do të arrijë. [...] Komisioni konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore, pavarësisht nivelit të ulët të provueshmërisë gjatë hetimeve dhe megjithëse nuk arriti në një vlerësim negativ për këtë kriter, në vlerësimin tërësor gjen të zbatueshëm pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të të cilit kjo rrethanë mund të konsiderohet si tregues i cenimit të besimit të publikut te drejtësia”.

24.2. Kolegji vëren se me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, është përcjellë në Komision raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Selim Kryeziu, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës. Te ky raport nuk ishte i përfshirë raporti i Shërbimit Informativ të Shtetit. Nga informacioni i ardhur nga institucioni i verifikimit rezulton se për subjektin e rivlerësimit Selim Kryeziu, disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari korruptive në një çështje penale në Gjykatën e Apelit Shkodër, të cilat sinjalizojnë mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv në bashkëpunim. Me raportin e rishikuar nr. {\*\*\*} prot., datë 19.02.2019, të DSIK-së, vlerësohet se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c”, të nenit 37 të ligjit nr.

84/2016, ku subjekti Selim Kryeziu vlerësohet si individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

**24.3.** Komisioni, në kuadër të rezultateve të raportit të DSIK-së, ka kërkuar informacion në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë dhe kjo e fundit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2020, ka informuar se nga verifikimet e kryera rezultoi se subjekti Selim Kryeziu është përmendur në referimin e fillimit të hetimit në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2019. Sipas informacionit të kësaj shkrese ky procedim është në fazën e seancës paraprake, pasi është dërguar kërkesa për pushimin e hetimeve. Për të verifikuar më tej, Komisioni kërkoi informacion në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri në momentin e procesit të rivlerësimit, si dhe administroi dosjet e përmendura në indiciet e DSIK-së. Komisioni, pas administrimit të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 05.06.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, vëren se ndaj subjektit Selim Kryeziu janë depozituar 3 ankesa, si dhe referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 05.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor vëren se ndaj subjektit Selim Kryeziu janë depozituar 9 ankesa.

**24.4.** Kolegji konstaton se për efekt të hetimit administrativ Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër, lidhur me dosjen e gjykimit me të pandehur E. R., akuzuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër, kjo e fundit ka bashkëngjitur vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.11.2018, për të pandehurin E. R.. Sipas këtij vendimi konstatohet se subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu është në cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore (të përbërë nga A. N. kryesues dhe L. H. anëtare), në çështjen penale me të pandehur E. R., akuzuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2018, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit E. R. për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Bazuar në nenin 406/1 të K. Pr. Penale dënohet me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.* Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe i pandehuri E. R..

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.11.2018, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me këtë ndryshim: Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit dhe vënien në provë të të pandehurit E. R. për një afat prej 4 vitesh dhe detyrimin për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës Shkodër.*

**24.5.** Gjithashtu, referuar në indiciet e DSIK-së, Komisioni ka thirrur në cilësinë e dëshmitares në datën 19.12.2019 shtetasen A. P., me detyrë prokurore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila u pyet lidhur me akuzat e ngritura nga ana e saj kundrejt subjektit Selim Kryeziu dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër A. N., në cilësinë e anëtarëve të trupit gjyqësor në një prej çështjeve të hetuara prej saj. Sipas indicieve, prokurorja ka bërë disa komente në ambiente publike për shkelje serioze të bëra nga subjektet e mësipërme. Prokurorja deklaroi në Komision se nuk kujton të ketë pasur debate apo të ketë bërë komente lidhur me këto subjekte rivlerësimi në ambiente publike, pasi është shumë e kujdesshme në këtë pjesë, por nuk e përjashtoi mundësinë që edhe mund ta ketë harruar një fakt të tillë. Në lidhje me dëshminë e prokurores A. P., subjekti i rivlerësimit deklaroi në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit se sulmet ndaj tij kanë filluar menjëherë pas gjykimit të masës së sigurimit të bashkëshortit të saj,

shtetasit P. P., ish-prokuror i dënuar penalisht, si dhe gjykimeve të tjera civile me vëllain e saj G. Y., si paditës ose si përfaqësues i palëve të ndryshme në cilësinë e avokatit, ku ky i fundit, sipas subjektit, ka arritur t'i bëjë presion edhe mbrojtësve të tjerë të caktuar kryesisht nga gjykata për të mos u futur në gjykim.

**24.6.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me faktin se ka informacione për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, të cilat cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se raporti i dytë i bërë në datën 19.02.2020 nga DSIK-ja nuk është i mbështetur në prova dhe fakte të bazuara, por thjesht në dyshime aspak ligjore. DSIK-ja dhe institucionet e tjera që kanë përpiluar raportin kanë pasur detyrimin ligjor, bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale “Kallëzimi nga nëpunësit publikë”, për të paraqitur kallëzim penal pranë organit të hetimit, nëse nga këto akte është konstatuar se ka elementë të veprave të ndryshme penale, përndryshe mbajnë përgjegjësi ligjore për moskallëzim krimi. Lidhur me informacionet e marra nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ku rezulton se subjekti është përmendur në informacionin e policisë me titull “Informacion për referimin e veprës penale”, në hetimin në kuadër të procedimit penal nr. 114/2019, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka dijeni për një procedim penal ndaj tij, pasi nuk është thirrur ndonjëherë. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në kushtet kur ky procedim penal është pushuar ndaj personave që janë zhvilluar hetime nuk duhet të përdoret për vlerësimin e figurës së tij.

**24.7.** Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore në Komision dorëzoi në cilësinë e provës, vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ku evidentohet kërkesa me objekt “Pushim i hetimeve për procedimin penal nr. {\*\*\*}, pasi nuk provohet se fakti ekziston”. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2019.* Në tekstin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2020, gjendet e argumentuar se me vendimin e datës 18.12.2019, ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore dhe kalimin e akteve për procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2018, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ku me Urdhrin e datës 20.12.2019, kjo e fundit ka regjistruar këtë procedim penal duke i dhënë numër tjetër tashmë (114/2019). Në gjykimin e kësaj kërkesë, duke qenë në kushtet kur ishte regjistruar vetëm procedimi (pa autor), gjykata, në zbatim të nenit 329/b, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk çmoi thirrjen e ndonjë subjekti tjetër në gjykimin e kërkesës me përjashtim të prokurorit.

Në arsyetimin e këtij vendimi vërehet, gjithashtu se në informacionin e policisë për referimin e fillimit të hetimit nuk tregohet asnjë burim prove, asnjë veprim i kryer deri në atë moment dhe asnjë fakt apo provë e marrë nuk vihet në dispozicion të prokurorit, me përjashtim të referimit të informacionit se ishte marrë informacion se shtetasi R.N. me funksion avokat, do të kryente ndikim të paligjshëm tek gjyqtarët. Në këtë vendim qartësohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër ishte shpallur që me datë 21.11.2018, pra, disponimi i kësaj gjykate ishte publik që në këtë datë dhe jo sipas informacionit të referimit të veprës penale, ku më datë 03.12.2018, informohej se do të merrej një vendim i tillë pas këtij informacioni.

**24.8.** Në analizë për sa referuar më sipër, Kolegjit i rezultoi se raporti i dytë i DSIK-së konstatoi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, në bazë të të cilit Komisioni hetoi duke i kërkuar informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kjo e fundit informoi se subjekti i rivlerësimit është përmendur në informacionin e policisë për referimin e fillimit të hetimit në kuadër të procedimit penal nr. 114, të vitit 2019, procedim penal i regjistruar për veprat penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, si dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, por procedimi penal nuk rezultoi të jetë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr ai shtetas të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas normave procedurale, në këtë moment personi merr cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e një veprave penale dhe ndaj tij zbatohen të gjitha dispozitat që zbatohen edhe për të pandehurin në një procedim penal, sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret të subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi të jetë regjistruar procedim penal në emër të tij, përveçse është përmendur emri në informacionin e policisë për referimin e hetimit që mban datën 03.12.2018. Komisioni e ka kualifikuar këtë situatë faktike si cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**24.9.** Kolegji vëren se nga të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së dhe të pasqyruara në vendimin e Komisionit, referohen dyshime për veprime me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm për subjektin e rivlerësimit. Grupi i punës së DSIK-së nuk rezultoi të ketë referuar të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të Kreut V, të ligjit nr. 84/2016 që rregullon kontrollin e figurës. Raporti i DSIK-së nuk përmban informacion se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës, ose, se ajo nuk është e plotë dhe e besueshme, sipas përcaktimeve të neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, Kolegji vëren se rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës.

**24.10.** Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji vlerësoi se lidhur me kriterin e kontrollit të figurës nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla që të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Përfundimet e Komisionit në vlerësimin e këtij kriteri janë të paqarta dhe jo në përputhje me standardet që Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 ka vendosur për kontrollin e figurës, për pasojë, gjenden të pambështetura në ligj dhe në prova. Komisioni nuk ka arritur të mbështetet në dokumente dhe argumente bindëse se faktet e parashtruara në raportin e DSIK-së plotësojnë rrethanat e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se çështjet e trajtuara nga Komisioni, si rrethana të cilat cenojnë besimin e publikut sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, nuk parashikohen nga ligji nr. 84/2016 si shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës, por edhe elementet e këtyre gjetjeve nuk janë të vlefshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

25. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Selim Kryeziu, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 278, datë 22.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 278, datë 22.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Selim Kryeziu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.12.2022.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*